
ARSIMI I ARTIT FIGURATIV për klasën e

9

Shkup, 2020

Autorë: Danço Ordev

Aleksandar Ordev

Recensentë:

Dr. Maja Raunik Kirkov, kryetare

Suta Topkoska, anëtare

Agim Saiti, anëtar

Përkthyes:

Metin Muaremi

Redaktim profesional:

Doc. Dr. Ejup Ajdini

Lektor i botimit në shqip:

Abdulla Mehmeti

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shtypi: Evropa 92, Koçan

Tirazhi: 693

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 22-2318/1 datë 21.04.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:73/76(075.2)=18

ORDEV, Danço

Arsimi i artit figurativ për klasëne IX / Danço Ordev, Aleksandar Ordev. - Shkup :

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2020.

- 110 стр. : илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-226-434-9

1. Ordev, Aleksandar [автор]

COBISS.MK-ID 111884810

Nxënës i dashur

Deri tani jemi njoftuar me shumë njohuri dhe e përvetësuar gjuhën e artit figurativ, përmes së cilës më mirë shprehemi si dhe e njohim artin figurativ.

Në këtë libër do ta rikujtojmë atë që e kemi mësuar në klasat e mëhershme dhe do të mundohemi të krijojmë punime të reja dhe origjinale.

Shpresojmë se nga klasa e IV e deri tani, jeni njohur me përmbajtje për gjuhën e artit, për materialet dhe teknikat e punës, jeni njohur edhe me veprat dhe emrat e krijuesve botërorë dhe maqedonas.

Ashtu si deri tani, analizoji dhe krahasoju përmbajtjet e veprave, ndërsa të paranjohurat le të shërbejnë që t'i krijosh vepra tua, përmes së cilave do të prezantohesh ti dhe ndjenjat tua.


Shpresojmë se edhe këtë vit do të kënaqeni gjatë krijimit të veprave, si dhe me lëndën e arsimit të artit figurativ, ndërsa arti figurativ çdo herë për ty do të paraqesë kënaqësi në jetë.

Autorët

MAQEDONIA

THESAR I ARTIT

4




AUTOPORTETE

TË ARTISTËVE TË NJOHUR TË ARTIT FIGURATIV



Antoan Vato: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Pol Gogen: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Foto 5: Albreht Direr: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Salvador Dali: **Autoportret**, vaj në pëlhurë




Foto 6: Diego Velaskez: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



AUTOPORTETI IM

(emri)

(mbiemri)

(klasa)

(shkolla fillore)

(Vizatoje autoportretin tënd në hapësirën e zbrazët)

Ezhen de la Kroa **Autoportret**, vaj në pëlhurë

Ticijan: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



PËRMBAJTJA

6

ARSIMI FIGURATIV	8
GJUHA E ARTIT FIGURATIV	10
Vija.....	12
Ngjyra	14
Toni.....	16
Tekstura	18
Kahja	20
Madhësia	22
Forma-dendësia	24
Hapësira	26
Kontrasti	28
Ritmi-përsëritja	30
Harmonia	32
Baraspesha	34
Gradacioni	36
Proporcioni	38
Uniteti	40
Kompozicioni	42
Motivi	44



FUSHAT E ARTIT FIGURATIV	52
VIZATIMI.....	54
Vija.....	56
Toni.....	57
Hapësira	58

PËRMBAJTJA



PIKTURA.....	60
Ngjyra	62
Toni	63
Kontrasti	64
Uniteti	65
Kompozicioni	66



FORMA.....	68
Ngjyra	72



GRAFIKA.....	74
Toni	78
Litografia.....	79
Shkrimi me teknikën sito.....	80



DIZAJNI DHE KOMUNIKIMI VIZUEL	82
VLERËSIMI ESTETIK	90
GALERIA.....	96
FJALOR I NOCIONEVE	102
TEST1	105
TEST 2	107

ARTI FIGURATIV

8

E dimë që njerëzit merren me veprimtari të ndryshme, me qëllim t'i lehtësojnë dhe zbukurojnë aktivitetet ditore, si dhe të mbijetojnë.

Artistët, krijojnë vepra me të cilat e zbukurojnë kohën tonë të lirë dhe na bëjnë të lumtur dhe më human. Ekzistojnë shumë lloje të arteve, siç janë: muzika, teatri, baleti, letërsia, fotografimi. Dihet se arti figurativ është njëri ndër ato.

Arti muzikor është e pandashëm nga përditshmëria dhe e plotëson çdo moment të jetës sonë.

Arti teatral paraqet ndjenjë të veçantë për çdo njeri, i cili e begaton jetën tonë me aktrim, lëvizje, ngjarje dhe të folurit që performohet në skenë.

Secili prej nesh, që ka përcjellë një shfaqje baleti, e din që baleti si art paraqet ndjenjë të veçantë në bukurinë e muzikës dhe lëvizjet e bukura të lojtarëve në skenë.



FILMI



FOTOGRAFIA



MUZIKA



BALETI



TEATRI



VIZATIM



SKULPTURË



GRAFIKË



DIZAJN



FRESKË



PIKTURË

Arti filmik është prezent në kohën tonë të lirë, përmes televizionit ose kur shkojmë në kinema, me qellim që të argëtohemi dhe pushojmë.

Çdo njeri dëshiron që të lexojë një libër të bukur, i cilë në çdo moment është shoku i ynë më i ngushtë. Letërsia si art e pasuron jetën tonë dhe mënyrën e shprehjes, na bën më të pasur dhe më të ndryshëm nga të tjerët.

Sot, arti i fotografimit na njofton me bukuritë rreth nesh. Përmes fotografimit njihemi me magjinë dhe specifikën e natyrës, qyteteve, jetën e njerëzve, dhe njëkohësisht i përcjell dhe na informon me ndodhitë në botë.

Arti figurativ është prodhim i shpirtit kreativ të njeriut që nga parahistoria e deri më sot. Krijimet figurative janë dëshmitare për zhvillimin e civilizimit dhe mendimit njerëzor.

Veprat e artit figurativ, për ne paraqesin pasuri shpirtërore shumë të çmueshme.


Arti figurativ paraqitet me vepra të cilat realizohen përmes materialeve të ndryshme, në hapësirën dy dimensionale dhe tri dimensionale.

ELEMENTET E ARTIT FIGURATIV

10

Të gjitha artet i kanë mjetet e tyre, përmes së cilave shprehen, muzika përmes tonit dhe melodisë, letërsia përmes fjalës, baleti përmes lojës, ndërsa filmi përmes ngjarjes. Arti figurativ shprehet përmes gjuhës së artit figurativ.

Gjuha e artit figurativ është pjesë e pandashme e elementeve të pikturës dhe parimeve të saj. Elemente e artit figurativ janë: *vija, ngjyra, toni, tekstura, madhësia, kahja, forma, dendësia dhe hapësira*. Parimet e pikturës janë: *kontrasti, përsëritja-ritmi, harmonia, baraspesha, gradacioni, proporcioni, uniteti dhe kompozicioni*.

**VIJA**


Vija bën pjesë në elementet e pikturës dhe atë e njohim si gjurmë në hapësirën ku vizatojmë dhe shkruajmë.

**NGJYRA**

Ngjyrën e shohim çdo kund rreth nesh dhe ajo i ngjyros me ngjyra të bukura gjërat e ndryshme që ndodhen rreth nesh.

**TEKSTURA**

Tekstura është paraqitje e sipërfaqeve të vrazhda apo të rrafshëta të disa objekteve.

**MADHËSIA**

Madhësia është element, i cili na tregon se gjërat rreth nesh janë më të mëdha ose më të vogla.

**HAPËSIRA**

Hapësira paraqitet në fotografi. Si hapësirë emërohet e gjithë ajo përmes së cilës lëvizim ne, zogjtë, automobilat dhe bimët rriten lirshëm.

**FORMA**

Formën veçse e kemi të njohur. Të gjitha gjërat, pra edhe ne vetë, kemi formë dhe në bazë të saj njihemi.

**TONI**

Kur një ngjyrë e njëjtë paraqitet më e errët apo më çelët, paraqet tonin. Ai fitohet shumë lehtë me përzierjen e ngjyrës me të bardhë apo me të zezë.

**KAHJA**

Kahja është drejtimi i të shikuarit të ndonjë vizatimi, fotografie, skulpture apo grafike.



KONTRASTI

Kontrasti është parim i kundërshtisë. Kjo do të thotë diçka të kundërt, si p.sh. dritë-errësirë, e madhe e vogël, ulët-lart, ngrohtë-ftohtë, etj.




GRADACIONI

Gradacioni mund të jetë fjalë e re, por përmes tij mësojmë se si në artin figurativ, në mënyrë të shkallëzuar ndryshojnë ngjyrat, vijat, tonet dhe elementet tjera.



UNITETI

Uniteti si parim e rregullon një vepër figurative në një tërësi të qetë.



RITMI

Përsëritjen apo ritmin e takojmë çdo kund, në muzikë tonet kanë ritëm. Dita dhe nata përsëriten, java, muajt dhe vitet gjithashtu, etj.




HARMONIA

Harmonia nënkupton se si vepra të jetë e harmonizuar dhe e bukur.

KOMPOZICIONI

Kompozicioni është parim themelor i cila na mëson se si t'i rregullojmë vijat, ngjyrat dhe tonet në veprën tonë.



PROPORCIONI

Proportioni paraqet mënyrën se si gjërat të vendosen në madhësinë e duhur në veprën si tërësi.



BARASPESHA

Baraspesha si parim na tregon se si vepra të jetë e matur, ndërsa renditja në të e baraspeshuar.

ELEMENTET E ARTIT FIGURATIV

12


VIJË

TË RIKUJTOJMË

Në klasat e kaluara gradualisht u njoftuam me gjuhën e artit figurativ. Në këtë klasë do të rikujtojmë atë që dimë, me qëllim që përmes punës krijuese më mirë të shprehemi dhe t'i shprehim ndjenjat dhe idetë tona dhe të krijojmë vepra të suksesshme artistike.

Vijat ndahen në dy lloje, të drejta dhe të lakuara, ndërsa mund të jenë të *trasha*, të *holla*, të *shkurta* dhe të *gjata*. Ndarje tjetër mund të jenë *kontura* dhe *tekstura*, ndërsa kemi edhe vija sipas karakterit.

Vija mund të jetë shprehje e materialit me të cilin punojmë, por ajo mund ta prezantojë edhe autorin. Secili që vizaton i shfaq vijat në mënyra të llojllojshme. Me vija fitohet karakteri i vizatimit që mund të jetë *i qetë* dhe *dinamik*. Vija në krijimin figurativ e plotëson formën.




Vija të drejta dhe të lakuara



Vija konture dhe teksture




Vizatim parahistorik

Ordan Petlevski: Vizion i zi,
Vizatim (vizatim dinamik)

Vijë në natyrë



Vizatim nxënësish



Vijë në natyrë



Leonardo da Vinçi: **Studim**, vizatim




Vizatim, thëngjill



Vizatim kompjuterik

Nëse në një krijim artistik përdorim për shembull, vetëm vija të drejta apo vija të njëjta, themi se ato vija janë *harmonike*. Vijat e harmonizuara janë ato të cilat mes vete janë të njëjta dhe të kombinuara bashkë duken të qeta.

Për dallim nga vijat harmonike, kemi edhe *vijat kontraste*. Vijat kontraste janë ato të cilat dallohen mes vete, siç janë vijat e lakuara dhe të drejta, të trasha dhe të holla, të shkurta dhe të gjata.



Predrag Uroshević: **Vizatim**, Tush (vizatim i harmonizuar)



Dimitar Manev: **Pa titull**, vizatim (teknikë e kombinuar)

TË MBAJMË MEND:

Vijat mes vete kombinohen në mënyrë kontraste dhe të harmonizuar. Sipas vijave vizatimet mund të duken të qeta dhe dinamike.

NGJYRA

TË RIKUJTOJMË

Tani më dimë më shumë për ngjyrat si një ndër tetë elementet e pikturës të gjuhës së artit figurativ. Primare është se ngjyra shihet vetëm kur kemi dritë.

Ndarja e parë e ngjyrave është se kemi *ngjyra primare* (e kuqe, e kaltër, e verdhë) dhe *ngjyra sekondare* (e portokallit, e gjelbër, vjollcë). Ngjyrat ndahen në *kromatike* dhe *akromatike*, të *ngrohta* dhe të *ftohta*, të *çelëta* dhe të *errëta*. Në përditshmëri, takohemi me termin *ngjyrë lokale*. Ngjyrë lokale do të thotë se disa sende çdoherë janë të ngjyrosura, apo i takojmë me një ngjyrë të caktuar (qielli, kullosa, limoni, portokalli, banane, etj).



Pasuri e ngjyrës në natyrë




Ngjyra primare dhe sekondare



Ngjyra kromatike, ylberi



Ngjyra akromatike



Rrushi, ngjyrë lokale



Anri Matis: **Grua me kapelë**, vaj në pëlhurë (ngjyra të ftohta dhe të ngrohta)



Dredhëza, ngjyra lokale



Limoni, ngjyra lokale



Molla, ngjyra lokale



Danço Ordev: **Manastiri Shën Jovan Osogovski**, vaj në pëlhurë (ngjyra të ftohta dhe të ngrohta)



Edvard Munk: **Vdekja**, vaj në pëlhurë (ndikimi psikik i ngjyrës)

TË MBAJMË MEND:

Ngjyra lokale është ngjyra me të cilën i takojmë disa gjësende rreth nesh.

ELEMENTET E ARTIT FIGURATIV

16

TONI

TË RIKUJTOJMË

Toni është sasia e dritës në një ngjyrë. Ekzistojnë *tone kromatike dhe akromatike*.

Tonet akromatike fitohen me përzierjen e ngjyrës së bardhë dhe të zezë, ndërsa tonet kromatike fitohen me përzierjen e ngjyrës së bardhë apo të zezë me ndonjë nga ngjyrat kromatike. Me të bardhë i ndriçojmë ngjyrat, ndërsa me të zezë i errësojmë.


Nëse kemi më shumë tone, të cilat gradualisht ndriçohen apo errësohen, atë e quajmë *shkallëzim tonik apo shkallë tonike*.



Tone akromatike



Tone kromatike




Shkalla tonike kromatike

Dragan Najdenovski: **Zona**, vaj në pëlhurë (ton)



Natyrë e vdekur, tone akromatike



Vojtech Prejsit: **Kulla në mermer**, vaj në pëlthurë (tone akromatike)



Foto 3: Rozhe Bertem: **Shkuarja e dimrit**, vaj në pëlthurë (tone kromatike)



Goce Bozhurski: **Fotografi**, vaj në pëlthurë (tone kromatike)



Edgard Dega: **Balerinat ushtrojnë**, vaj në pëlthurë (tone kromatike)

TË MBAJMË MEND:

Shkallëzim i toneve apo shkallë toni është kur kemi më shumë tone në një ngjyrë, të cilat gradualisht ndriçohen apo errësohen.

ELEMENTET E ARTIT FIGURATIV

18

TEKSTURA


TË RIKUJTOJMË

Teksturën e kemi në të gjitha sipërfaqet e materialeve. Ajo paraqitet në të gjitha krijimet e pikturës dhe në të gjitha sferat e pikturës. Pikturët, skulptorët dhe artistët e grafikës, në veprat e tyre kombinojnë tekstura të llojllojshme, përmes së cilave e begatojnë veprën e pikturës.


Teksturën mund ta kombinojmë në mënyra të ndryshme. Mund të bëjmë kontrast në sipërfaqe të fortë dhe të butë, të kombinojmë *unitet dhe harmoni me teksturë, si dhe kompozim dhe teksturë*. Secili prej nesh duhet të hulumtojë me materiale të llojllojshme që të bëjë sa më shumë tekstura në pikturat e veta, me të cilat do të fitojë një pikturë më interesante dhe me vlerë.




Teksturë artificiale




Teksturë artificiale




Teksturë e krijuar me kompjuter



Teksturë artificiale



Teksturë e ngjashme, tush, percë



Radoslav Tadiç: **Në kopsht**, vaj në pëlhurë (teksturë pikturë)




Vinsent van Gog: **Portreti Roulin**, tush, percë (teksturë)



Teksturë kontrasti, tush, percë



Teksturë natyre




D. Mojiç: **Definicion i tokës**, vaj në pëlhurë (teksturë pikturë)



Vepër nxënësi, **gjdhendje** (teksturë grafike)



Dimçe Protugjer: **Kompozicion**, vaj në pëlhurë (teksturë pikturë)



Danço Kalçev: **Pikturë 1877**, vaj në pëlhurë (teksturë pikturë)

TË MBAJMË MEND:

Me teksturë mund të fitojmë kontrast, harmoni dhe unitet. Secili autor duhet të hulumtojë tekstura të ndryshme dhe të llojllojshme.

KAHJA

20

TEKSTURA

TË RIKUJTOJMË

Kahja është element i pikturës si pjesë e gjuhës së artit figurativ edhe ajo është fuqi vizuale, e cila e lëviz syrin në kahe të caktuar. Sipas kahes së kësaj fuqie vizuale, dallojmë kahe: *horizontale*, *vertikale*, *kahe e pjerrët dhe vepra pa kahje*.


Pikturët i kompozojnë veprat e tyre me kahje të llojllojshme. Diku kemi edhe kombinim të më shumë kahjeve, me më tepër fuqi, më të shprehur në një kahje.



Kahje e pjerrët

Vizatim me laps
(kahje vertikale)

Pa kahje




Kahje horizontale në natyrë

Etijen Mari: **Studim homografik**, (kahje horizontale)Aleksandar Kalder: **Pilakë e portokalltë**, vaj në pëlhurë
(pa kahje)



Dimitar Koçoski: **Cikël zogjsh**, vaj në pëlhurë (kontrast i kahjes)

Ivan Generaliç: **Druprerësit**, vaj në pëlhurë (kahje horizontale)



Nikola Martinovski: **Gjidhënësja**, vaj në pëlhurë (kahje e pjerrët)



Foto 4: Vladimir Gjeorgjievski: **Kryqëzim me muzikantë**, vaj në pëlhurë (kahje vertikale)

TË MBAJMË MEND:

Në çdo vepër mbizotërojnë një apo më shumë kahje. Shumë pak vepra janë pa kahje.

KAHJA

22

MADHËSIA

TË RIKUJTOJMË

Madhësia është element i cila është pranishëm në të gjitha veprat artistike, nga *vizatimi, piktura, skulptura, grafika dhe dizajni*. Në varësi nga ajo se çfarë madhësish paraqiten në një vepër, ajo mund të duket *harmonike ose kontraste*.

Madhësia luan rol në dizajnin grafik. Në varësi nga ajo se çfarë funksioni ka ajo që dizajnojmë, duhet të kemi kujdes në madhësinë e tekstit në krahasim me ilustrimin, fotografinë dhe vizatimin.



Krijim me madhësi të njëjta

Mikelanxhelo, **gur**
(kombinim i madhësisë në hapësirë)

Kombinim harmonik i madhësisë



Kombinim madhësish kontrasti

Madhësia në disa vepra mund gradualisht të rritet apo zvogëlohet. Në këtë mënyrë fitohet *gradacioni i madhësisë*.




Foto 2: Jou Çun Vang: **Pamje nga Kina jugut** (kombinim harmonik i madhësive)



Edison Para: **Konstruksion** (gradacion i madhësive)



Kisha Notër Dam në Paris (madhësi në arkitekturë)

TË MBAJMË MEND

Madhësitë mund të kombinohen në mënyrë kontrasti dhe harmonike. Nëse madhësia gradualisht ndryshohet, atëherë kemi gradacion.

KAHJA

24


FORMA

TË RIKUJTOJMË


E dimë që forma është një ndër elementet e artit figurativ dhe gjuhës së pikturës. Forma është element i artit figurativ, e cila është e përhapur në të gjitha fushat e pikturës, në vizatim, në fotografim, grafikë dhe dizajn. Forma mund të jetë *e hapur, e thjeshtë dhe komplikuar, si dhe dy dimensionale apo tri dimensionale.*

Forma ndikon te njeriu me pamjen e tij. Disa forma duken të qeta ose të lëvizshme, në bazë të cilave i ndajmë në *statike apo dinamike*. Format statike janë ato të cilat me formën e tyre sugjerojnë qetësi.


Forma dinamike janë ato të cilat sipas formës së tyre sugjerojnë paqetësi dhe lëvizje. Kryesisht, format dinamike kanë pamje rrethore.



Formë e hapur



Formë e mbyllur




Formë e thjeshtë



Formë dy dimensionale dhe tre dimensionale



Formë e performuar

Tmavac: **Formë artistike**, dru (formë e komplikuar)

Formë dy dimensionale




Formë e performuar



Formë dinamike



Formë dinamike



Formë statike



Formë statike



Robert Rauschenberg, **Për nder të Bleriotit**, vaj në pëlhurë (formë dinamike)



Krsto Slavkovski: **Vuajtje**, dru (formë tri dimensionale e komplikuar)



Vasil Vasilev: **Formë asociative vertikale**, dru (formë e komplikuar tri dimensionale)

TË MBAJMË MEND:

Dallojmë forma dy dimensionale dhe tri dimensionale, statike dhe dinamike, të komplikuar dhe të thjeshta.

KAHJA

26

FORMA

TË RIKUJTOJMË

Hapësira rreth nesh është hapësirë reale, ndërsa ajo e cili paraqitet në veprat artistike është iluzion i hapësirës. Me përdorimin e elementeve të ndryshme të gjuhës së pikturës mund të shprehet iluzion në hapësirë, me ngjyra të çelura-mbyllura dhe të ngrohta-ftohta, me forma të mëdha dhe të vogla, me përputhje dhe me perspektivë.

Hapësira ndahet në hapësirë të brendshme dhe të jashtme, respektivisht e mbyllur dhe e hapur. Hapësira e brendshme është e mbyllur nga ajo e jashtme dhe në të njeriu jeton, punon, mëson, fle dhe argëtohet (dhomë, banesë, ndërtesë, teatër, klasë, kinema).

Hapësira e jashtme apo e hapur është ajo në të cilën lirshëm lëvizin njerëzit, kafshët, zogjtë, veturat, aeroplanët (rrugë, fushë, livadh, mal, qiell).




Vinsent van Gog: **Barka peshkatarësh në plazh**, vaj në pëlhurë (hapësirë e hapur)




Hapësirë reale



Hapësirë me përputhje




Jozo Hamaguçi: **Pullaze Parisi**, vaj në pëlhurë (hapësirë me përputhje)



Skicë e banesës (hapësirë e komplikuar)



Borko Lazeski: **Bon marshe**, vaj në pëlhurë (hapësirë e hapur)



Huskoviç: **Peizazh**, Teknikë e kombinuar (hapësirë me ngjyra të çelëta dhe të mbyllura)



Hapësirë e paraqitur me perspektivë

Hapësira mund të jetë e thjeshtë dhe e komplikuar. Hapësira e thjeshtë është e përbërë vetëm nga një hapësirë, ndërsa e komplikuar nga më shumë, të cilat janë të lidhura mes vete. Hapësirë e thjeshtë është dhoma, korridori, klasa, ndërsa e komplikuar është shkolla, ndërtesa, fshati, qyteti dhe banesa.



Vasilij Kandinski: **Disa rrathë**, vaj në pëlhurë (hapësirë e madhe dhe e vogël, e çelët dhe e mbyllur)



Vasilij Kandinski: **Disa rrathë**, vaj në pëlhurë (hapësirë e madhe dhe e vogël, e çelët dhe e mbyllur)

TË MBAJMË MEND:

Dallojmë hapësirë të hapur dhe të mbyllur, të komplikuar dhe të thjeshtë. Paraqitja më reale e hapësirës arrihet me perspektivë.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

KONTRASTI

TË RIKUJTOJMË

Deri tani i mësuam elementet e pikturës. Nga kjo pjesë do të fillojmë me parimet e pikturës. Kontrasti është parim figurativ, i cili përdoret në të gjitha elementet e pikturës: *me vijë, me ngjyrë, teksturë, kahje, madhësi, formë, hapësirë.*

Vijat në një vepër mund të jenë në kontrast nëse i përdorim të trasha dhe të holla, të shkurta dhe të gjata, të drejta dhe të shtrembëta.

Ngjyra mund në shumë mënyra të jetë kontraste, si e çelët apo mbyllur, e ngrohtë, e ftohtë ose komplementare.

Toni mund të përdoret si i errët dhe më me shumë dallime mes vete.

Kontrasti në veprat artistike dallohet për nga madhësia, nëse përdoren forma të mëdha dhe të vogla.

Në veprat artistike, shpesh dominon vetëm një kahje, ndërsa në disa vepra përdoret kontrast i kahjes. Ajo është si dy kahje të kundërta me fuqi, intensitet dhe veprim në të njëjtën kohë.



Kontrast i vijës



Kontrast i vijës



Kontrast i ngjyrës së ftohtë dhe të ngrohtë


Risto Kalçevki: **Piktura 88-68**, vaj në pëlhurë (kontrast drite dhe errësire, si dhe kahje)Edo Murtiq: **Brazili**, vaj në pëlhurë (kontrast i ngjyrës dhe madhësisë)

Kontrast i ngjyrës së çelët dhe të mbyllur

PARIMET E ARTIT FIGURATIV



Kontrast i vijave të drejta dhe të shtrembëta



Kontrast formash




Kontrast formash dhe madhësish



Valbona Rexhepi: **Gjurmë nga shekulli i ri**, akril (kontrast formash të mëdha dhe të vogla)



Kontrast komplementar



Kontrast ndriçimi, errësirë, ngjyrë dhe madhësi



Endi Vorhold: **Mao Ce Tung** (kontrast ngjyrash)

TË MBAJMË MEND:

Kontrasti mund të shprehet me vijë, ngjyrë, ton, formë, hapësirë, teksturë, kahje dhe madhësi.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV


30

RITMI


TË RIKUJTOJMË

Ritmi është parim i artit figurativ i cili i rregullon elementet e pikturës. Secili element mund të përdoret në ritëm të rregullt apo alternativ. Ritmi i rregullt është i thjeshtë, pasi që përsëriten elementet e njëjta, të cilat gjatë përsëritjes nuk ndryshojnë.


Gjatë përdorimit fitohet dinamikë në veprën artistike, ndërsa me ritmin e rregullt krijimi duket monoton dhe i mërztishëm.



Ritëm i rregullt



Vepër nxënësish (ritëm i rregullt)



Ritëm i rregullt



Vepër nxënësish (ritëm i rregullt dhe alternativ)



Endi Vorhold: Tri portrete, (formë e rregullt)



Ritëm alternativ




Vizatim me kompjuter (ritëm alternativ)



Ritëm i lirë



Ritmi në krijimin popullor



Vencislav Rihter: **Skulpturë**, alumin (ritëm)



Klod Viala: **Përsëritja për nder të HB**, vaj në pëlhurë (përsëritje e rregullt)

TË MBAJMË MEND:

Ritmi i rregullt duket i thjeshtë dhe i qetë, ndërsa ritmi alternativ duket i gjallë dhe dinamik.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

32


HARMONIA

TË RIKUJTOJMË

Të gjitha parimet e artit figurativ i rregullojnë disa raporte në veprën artistike. Harmonia është një ndër parimet, e cila i sjell elementet në harmoni mes vete, përmes vlerave të ngjashme apo të njëjta, ose përmes përmbajtjes së motivit.

Dallojmë harmoni sipas analogjisë, harmoni të funksionit dhe harmoni në bazë të idesë. Harmonia sipas analogjisë është e kombinuar me elementet e pikturës: vija, ngjyra, toni, madhësia, forma, kahja dhe tekstura.


Harmonia, sipas idesë është e lidhur me përmbajtjen e motivit, por e lidhur gjithashtu me ide dhe simbole.



Harmoni me vijë




Harmoni me ngjyra

Brixhit Rajlli: **Ndriçim i hershëm**, vaj në pëlhurë (harmoni me formë dhe madhësi)Ordan Petlevski: **Monument**, vizatim (harmoni me vijë dhe teksturë)

Krijim me kompjuter (harmoni me formë dhe ngjyrë)



Ilija Koçoski: **Shi vere**,
(harmoni me formë dhe ngjyrë)



Harmoni sipas funksionit



Harmoni sipas funksionit



Harmoni sipas idesë

Harmonia, sipas funksionit është kur motivi dhe përmbajtja i bashkon më shumë sende, të cilat janë të lidhura në funksion mes vete.



August Herbin: **Kompozicion**, vaj në pëlhurë (harmoni sipas formës)



Naumovski: **Grua në kopsht**, vaj në pëlhurë
(harmoni me formë dhe madhësi)

TË MBAJMË MEND

Harmonia arrihet përmes vlerave të përafërta dhe të njëjta. Dallojmë harmoni analoge, sipas funksionit dhe idesë.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

34

BARASPESHA

TË RIKUJTOJMË

Baraspesha është parim i artit figurativ përmes së cilës rregullohet renditja e elementeve në një tërësi. Baraspesha mund të përdoret në të gjitha elementet e artit figurativ. Dallojmë baraspeshë *simetrike dhe asimetrike*.

Baraspesha simetrike përdoret në krijimet dekorative, në krijimet popullore, veshje dhe *arkitekturë*.

Baraspesha asimetrike ndërtohet me qëllim të njëjtë, renditja nga ana e majtë të jetë e barabartë sipas vlerës së vijës, tonit, ngjyrës, teksturës, madhësisë dhe formës, por të jetë e ndryshme në të dyja anët.



Baraspeshë simetrike



Baraspeshë simetrike


Tereza Maçikalo: **Gjurmë** (baraspeshë asimetrike)**Maskë** (baraspeshë simetrike)



Baraspeshë simetrike




Baraspeshë asimetrike




Baraspeshë asimetrike



Baraspeshë simetrike në krijimet popullore maqedonase



Miftar Memeti: **Pa titull**, vaj në pëlhurë, (baraspeshë asimetrike)



Simteri



Baraspeshë simetrike në krijimet popullore maqedonase

TË MBAJMË MEND:

Ekzistojnë dy lloje të baraspeshës, simetrike dhe asimetrike.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

36

GRADACIONI


TË RIKUJTOJMË

Nga tetë parimet e artit figurativ dhe të gjuhës së artit figurativ, gradacioni i rregullon *gradualisht ndryshimet* tek elementet e artit figurativ. Vlerën e vet, gradualisht të gjitha elementet mund ta ndryshojnë, mund të kalojnë nga një vlerë në tjetër.

Gradacioni mund të përdoret te të gjitha elementet: *vija, ngjyra, toni, tekstura, kahja, forma, madhësia dhe hapësira*.



Gradacion me teksturë



Gradacion me ngjyrë



Gradacion me ton




Gradacion me ngjyrë



Gradacion me ton



Gradacion me madhësi



Gradacion me ton dhe madhësi



Gradacion me ton (iluzion i dendësisë)



Gradacion me ngjyrë

Me gradacion të tonit, ngjyrës dhe teksturës mund të fitohet *iluzion tre dimensional*.

Ngjyra me gradacion mund të ndryshohet nga njëra në tjetrën, të tretë, nga e verdha në të portokallit, të kuqe, vjollcë, kaltër, gjelbër dhe sërish të vijë deri në të verdhë, si në spektrin e ngjyrave.



J. Raçi: **Vajza para pasqyrës**, vaj në pëlhurë (gradacion i tonit, iluzion i tre dimensionalitetit)

TË MBAJMË MEND:

Gradacioni mund të përdoret në të gjitha elementet e artit figurativ. Me gradacion fitojmë iluzion dhe dendësi

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

38

PROPORCIONI

TË RIKUJTOJMË


Proporcioni është parim i artit figurativ, i cili i rregullon raportet e brendshme të madhësisë, me qëllim që tërësia artistike në aspektin estetik të jetë më e bukur.

Proporcioni synon kah ndërtimi ideal i fotografive, skulpturave dhe objekteve në arkitekturë. Me këtë problem në histori janë marrë shumë krijues, ndër to edhe *Leonardo da Vinçi*.


Rregull më e mirë për raporte ideale në lidhje me artin figurative janë arritur me prerjen e artë dhe çelësin e vet, ose formulën se si të arrihet ajo.



Proporcion i shkronjës



Prerja e artë




Proporcion i trupit të njeriut




Përmendorja Makedonium, Krushevë (proporcion në arkitekturë)




Leonardo da Vinçi, vizatim (proporcion i kokës)



Prerja e artë




Proporcion i tempullit të kishës




Apoloni dhe gjarpri, Greqi (proporcion në skulpturë)



Partenon, Akropoli, Greqi (proporcion në arkitekturë)



Proporcion i trupit të njeriut



Proporcion në ndërtimin e Partenonit

TË MBAJME MEND:

Proporcioni është raport ideal i madhësisë në një tërësi. Prerja e artë është bazë për arritjen e proporcioneve ideale.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

40

UNITETI

TË RIKUJTOJMË


Nga tetë parimet e artit figurativ, uniteti është parim që ka për qëllim ta rregullon tërësinë në një vepër pikturë. Me përdorimin e unitetit, vepra artistike nuk është e ndarë ose e pjesërishme, por ngjan si një tërësi estetike.

Uniteti arrihet përmes përdorimit të vlerave të njëjta, apo të përafërta dhe në bazë të dominantës. Përmes rrugës së *dominantës*, do të thotë kur elementet e pikturuar dominojnë në krijimin e pikturues, respektivisht është më e përfshirë. Ajo mund të jetë vijë, ngjyrë, ton, teksturë, madhësi, kahje ose hapësirë.


Përveç me dominantë të elementeve të pikturës uniteti mund të arrihet edhe me rritje apo përforsim. Ajo do të thotë, kur në një vepër pikturë nga forma, tone apo ngjyra të ndryshme njëra është aq shumë e zmadhuar sa që dominon në tërë veprën.



Vinsent van Gog: **Irisi**, vaj në pëlhurë
(unitet me ngjyrë dhe formë)



Unitet me dominantë të ngjyrës
dhe vijës



Unitet me dominantë të formës



Lubomir Popović: **Homazh për Xhemsin**, vaj në pëlhurë
(unitet me dominantë të tonit)



Unitet në formë




Hans Hartung: **Nr.116**, vizatim (unitet në vijë)




Unitet me formë dhe ton



Foto 3: Jan Arp: **Lule**, vaj në pëlhurë (unitet në formë)



Unitet në formë dhe ton



Unitet në madhësi dhe formë



Zhorzh Brak, **Kitaristi**, vaj në pëlhurë (unitet në formë dhe ton)

TË MBAJMË MEND:

Uniteti arrihet duke përdorur vlera të ngjashme apo të njëjta, me dominantë, me zmadhim dhe përforcim.

PARIMET E ARTIT FIGURATIV

42

KOMPOZICIONI

TË RIKUJTOJMË

Kompozicioni është parim i artit figurativ, i cili e rregullon renditjen e elementeve të artit figurativ në një krijim figurativ, si një tërësi të plotë. Si ndarje e parë është kompozicioni *horizontal*, *vertikal* dhe *diagonal*.

Kompozicionin mund ta definojmë edhe si të hapur, të mbyllur dhe gjysmë të hapur, në varësi nga ajo se si janë të renditura elementet figurative.

Kur elementet figurative janë të renditura ashtu që në aspektin vizual janë të hapura vetëm në disa anë, atëherë themi se kemi kompozicion gjysmë të hapur.



Albona Skiritute: **Tri motrat e paqes**, (kompozicion vertikal)



D. Pulitka: **Vreshta**, vaj në pëlthurë (kompozicion horizontal)



Dushan Otaçeviq: **Venera**, vaj në pëlthurë (kompozicion vertikal)



Lubica Solakovska: **Lojë**, vaj në pëlthurë (kompozicion i mbyllur)



Petar Haxhi Boshkov: **Skulpturë**, metal (kompozicion vertikal)

PARIMET E ARTIT FIGURATIV



Kompozicion i hapur rrjetor



Krijim nxënësish (kompozicion i mbyllur)



Krijim kompjuterik (kompozicion i hapur)




Kompozicion gjysmë i hapur

Nëse elementet figurative janë të vendosura në pjesë qendrore të vizatimit, fotografisë ose grafikës, kemi kompozicion të mbyllur. Kompozicion të hapur kemi kur elementet figurative janë të rënditura në të gjithë hapësirën e krijimit dhe vizuelisht dalin në të gjithë anët e tërësisë, majtas, djathtas, lart, posht.

Në disa teori të krijimit artistik mund takohen edhe disa lloje të kompozicioneve si: *të lira, rrjetshme, piramidore, rrethore, spirale* etj.



Version kompozicioni me një element



Rozeta (kompozicion i mbyllur rrjetor)

TË MBAJMË MEND:

Dallojmë kompozicion horizontal, vertikal dhe diagonal. Kompozicioni mund të jetë i hapur, gjysmë i hapur dhe i mbyllur.

ARTI FIGURATIV

Në këtë kapitull do të rikujtohem për motivin në artin figurativ. Në të njëjtën kohë do të njihemi me krijues të ri dhe vepra nga Maqedonia dhe bota, me të cilën do t'i pasurojmë njohuritë tona për artin figurativ.


Tani më e dimë se çdo vepër artistike është kombinim i një pasurie vijash, ngjyrash, formash, dendësive, tonesh dhe vlera të tjera figurative. Nëse në një vepër artistike dallojmë *një përmbajtje të caktuar nga ajo që na rrethon, themi se ajo vepër është me motiv. Nëse vepra është kombinim nga vetëm vlera figurative, themi se është abstrakte, respektivisht se nuk ka motiv.*



Angeliko: **Shën Katerina**, temperë (motiv)



Vermeer: **Dhoma**, vaj në pëlhurë (motiv)



Endi Vorhold: **Ingrid Bergman**



Eugen Kokot: **Kodra të kaltra**, vaj në pëlhurë (abstrakte)



Mark Rotko: **E bardha dhe e gjelbra në të kaltër**, vaj në pëlhurë (abstrakte)



Tome Serafimovski: **Portret i Slavko Janevskit**, bronz

PORTRETI

Në veprat e prezantuara dallojmë paraqitje të ndonjë personi. Do të dallojmë se piktori, me çdo karakter të paraqitur ka munduar ta paraqesë edhe karakterin e vet. Këtë motiv e quajmë **portret**.


AUTOPORTRETI

Shumë krijues, përveç se kanë prezantuar figura të tjera, shpesh e kanë punuar edhe portretin e vet, respektivisht e kanë paraqitur vetveten.

Në artin figurativ këtë e quajmë **autoportret**.



Ogist Renoar: **Portreti i Klod Mones**, vaj në pëlhurë



Dimitar Manev: **Portret**, teknikë e kombinuar



Dante Aligieri : **Detaj nga freska**



Pablo Pikaso, **Autoportret**



Vilijam Turner: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Elizabet Ie Braun: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Pol Kle, **Autoportret**



Leonardo da Vinçi, **Autoportret**, vizatim

KARIKATURA

Përveç vetive pozitive të njeriut, tek disa njerëz dominojnë karakteristikat negative, siç janë lakmia, pandershmëria, e keqja, varësia, etj. Disa krijues këto karakteristika i potencojnë në veprat e tyre, me çka ky motiv quhet **karikaturë**.



Karikaturë e zotëri Binit

Onore Domie: **Intelektuali i sëmurë**, litografiOnore Domie: **Konte**, bronzOnore Domie: **Krispen dhe Skapen**, vaj në pëlhurë

FIGURA

Sot duke shikuar disa vepra të artit figurativ njihemi me pamjen dhe mënyrën se si janë veshur njerëzit në të kaluarën. Kur në një vepër prezantohet njeriu me veshjen e tij, ky motiv quhet figurë.

Edgar Dega: **Balerina e vogël**Leonardo Da Vinçi: **Rafaeli**, pjesë e freskës



Ogist Renoar: **Në shëtitje**, vaj në pëlhurë



Angeliko: **Shën Katerina**, temperë



AKTI

Nëse artisti paraqet trup të njeriut pa veshje, kjo vepër quhet *akt*.

Sipas asaj që prezantohet, dallojmë akt femrash dhe akt meshkujsh.



Anri Matis: **Akt në studio**, vizatim




Albreht Direr: **Adami dhe Eva**, vaj në pëlhurë

Pol Gogen: **Tahiqanka**, vaj në pëlhurë



Jan Shtursa: **Puberteti**, bronz



Ogist Renoar: **Vasha**, vaj në pëlhurë

ZHANRI


Nëse në veprën figurative shohim përmbajtje nga jeta e përditshme, nga e tashmja apo e kaluara, themi se motivi paraqet **zhanër**.



Fransoa Mile: **Mbjellësi**, vaj në pëlhurë



Edgar Dega: **Familja Beleli**, vaj në pëlhurë



Edgar Dega: **Gotë pelinkovec**, vaj në pëlhurë



Jan Vermer: **Pianistja**, vaj në pëlhurë



Eduard Mone: **Ngrënie mëngjesi në kullosë**, vaj në pëlhurë

Vinsent van Gog: **Darkë me patate**, vaj në pëlhurë

KAFSHË

Vetë titulli na tregon se ky motiv i paraqet kafshët. Kafshët dallohen me bukurinë e tyre, secila në mënyrën e vet. Njerëzit, shpesh disa kafshë i ruajnë si kafshë shtëpiake, për shkak të bukurisë së tyre. Për këtë shkak, disa krijues janë inspiruar nga pamja e tyre dhe i kanë paraqitur në veprat e veta.



Vasko Tashkovski: **Skicë**, vizatim



Vizatim parahistorik nga Lasko



Enë e kuqe në formë lope, terakotë, Teheran



Etien Falkonet: **Përmendore e Pjetrit të Madh**, bronz



Relief



Himerë etruske, bronz

ENTERIERI

Në vizatim, pikturë apo grafikë shpesh njohim prezantim të hapësirës së brendshme. Hapësira mund të jetë vendi ku jetojme, punojmë ose argëtohemi. Shfaqjen e hapësirës së brendshme e quajmë *enterier*.



Tuluz Lotrek: **Lojtar i zi në bar**, vizatim



Anri Matis: **Enterier**, vaj në pëlthurë



Robert Kampini: **Shpallja**, vaj në dru



Vinsent van Gog: **Kafene nate**, vaj në pëlthurë

PEIZAZHI

Njeriu shpesh shkon në shëtitje në natyrë, për shkak të bukurisë së saj.

Pasuria e natyrës i ka inspiruar shumë krijues, të cilët në pëlhurat e tyre e kanë përjetësuar këtë bukurri. Shpesh hasim dhe kënaqemi me vepra në të cilat është paraqitur *peizazh*.




Danço Ordev: **Peizazh**, vaj në pëlhurë




Pol Sezan: **Peizazh**, vaj në pëlhurë



Edvard Hoper: **Peizazh me rrugë**, vaj në pëlhurë



Rembrandt: **Afër shkëputjes**, vaj në pëlhurë



Rubens Korubin: **Kopsht**, akril



Nikola Martinovski: **Peizazh nga Zapreshiqi**, vaj në pëlhurë

NATYRA E VDEKUR

Nëse në përmbajtjen e veprës njohim lule të llojlojshme, sende apo gjëra që nuk janë të gjalla, themi se ajo vepër ka motiv *natyrë e vdekur*.



Danço Kal'çev: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë



Pablo Pikaso: **Bokall dhe enë për frute**, vaj në pëlhurë



Natyrë e vdekur



Pablo Pikaso: **Natyrë e gjelbër e vdekur**, vaj në pëlhurë



Natyrë e vdekur



France Slana: **Lule**, vaj në pëlhurë



Pol Sezan: **Pjeshkë dhe qershi**, vaj në pëlhurë


ARTI FIGURATIV

52

Historia e artit merret me studimin e artit figurativ, nga parahistoria e deri më sot. Njerëzit kanë krijuar vepra të ndryshme nga materiale të ndryshme. Sipas shkencës, në art kemi pesë fusha të cilat dallohen sipas specifikave figurative të hulumtimit, edhe atë: *vizatimi, piktura, skulptura, grafika dhe komunikimi vizual me dizajnin*. Të gjitha këto pesë fusha i kanë karakteristikat e veta dhe secila në mënyrë të veçantë sjell bukuri dhe vlerë. Arti figurativ është pasuri e civilizimit njerëzor dhe e shpirtit kreativ.



Krryqëzimi i Krishtit, ikonë, Ohër

Vasko Tashkovski: **Cirku**, tush, perçe

Vizatim me thëngjill

Ibraim Bedi: **Zogu i vetmuar**

Triumfi i Titos, relief

ARTI FIGURATIV



Burhan Ameti: **Ëndërr e rrejshme**, akuatinta



Pol Sezan: **Lojtar letrash**, vaj në pëlhurë



Ogist Roden: **Balzaku**, gur



Krijim nxënësi, gdhendje



Jagoda Buiq: **Formë e ndryshme**, tapiceri



Vitrinë



Ilustrim



Dizajn stolish



Dizajn sendesh



Flamuri i Maqedonasë



Dizajn veshjesh

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

54

Në periudhën e kaluar, në lëndën e arsimit figurativ, kemi realizuar shumë vepra figurative nga fusha të ndryshme dhe me teknika të llojllojshme. Veç më e dimë se vizatimi është njëra nga fushat e arsimit figurativ. Bëjmë vizatime para se të fillojmë të pikturojmë, e vizatojmë idenë për grafikë, ndërsa me vizatim bëjmë edhe skicë për idenë se si duhet të duket një vepër skulpture, të cilën duam ta modelojmë.

Gjatë të vizatuarit përdoren materiale dhe teknika të llojllojshme, me të cilat do të krijojmë vizatim. Përdoren materiale të llojllojshme, pasi përmes vijave të ndryshme arrihet bukuri specifike.

Gjatë orës së arsimit figurative vizatohet me *laps*, *thëngjill*, *shkumësa të ndryshëm me ngjyra*, *pastel*, *pastel dylli*, *tush*, *lapsa me ngjyrë*, *si dhe me ngjyra temperë dhe akuarele*.

Artisti, vet e zgjedh materialin me të cilin e ralizon vizatimin. Zgjedhja e materialit varet nga dëshira, interesi dhe karakteri i autorit. Gjithashtu, edhe nxënësi mund ta zgjedh materialin për të cilin është më i interesuar. Vizatimi mund të punohet vetëm me përdorimin e një materiali, psh: *laps*, *thëngjill*, *tush*, *lapsa me ngjyra*, *pastel*, *pastel dylli*, *shkumës*, ndërsa mund të përdoren ngjyra akuarele dhe temperë. Mund të punohet vizatim me teknikë të kombinuar, respektivisht të vizatohet me më shumë teknika në një vizatim.



Pablo Pikaso: **Studim për perden**, laps (vizatim linear)



Pablo Pikaso: **Gruaja me qenin**, tush, percë



Leonardo da Vinçi: **Studim me laps**



Albreht Direr: **Zogu**, vizatim me akuarel



Vinsent van Gog: **Ura**, tush i derdhur



Vizatim me laps



Zhorzh Sera: **Vizatim**, thëngjill, (vizatim tonik)




Tuluz Lotrek: **Anglezi**, pastelin

Disa krijues, para se t'i punojnë vizatimet e tyre, kombinojnë ngjitje të kolazhit të letrës. Kur kombinohet vizatimi me kolazh fitojmë të ashtuquajturën vizatim me kolazh.

Karakteristikë themelore figurative e vizatimit është përdorimi i vijës, ndërsa këtë vizatim e quajmë vizatim linear. Në vizatim përdorim edhe tone të ndryshme, me çka fitojmë edhe vizatim tonik. Nëse në vizatim vërejmë ndonjë përmbajtje, ai vizatim është me motiv, ndërsa nëse nuk ka motiv themi së është abstrakt.


Të gjithë krijuesit, me veprimtarinë e tyre shpesh eksperimentojnë me materiale të ndryshme, që sa më mirë ta shprehin idenë dhe të bëjnë krijimin sa më interesant. Gjatë të vizatuarit përdorin edhe veprime të ndryshme, siç janë *thyerja*, *perforimi*, *ndërprerja*, *aplikimi*, *shtypje të gjurmëve të ndryshme*, etj. Secili krijues i ynë, si dhe nxënësit, duhet të krijojnë ide të reja dhe të eksperimentojnë gjatë shprehjes figurative.



Tanja Tanevska: **Bisedë**, teknikë e kombinuar



Pablo Pikaso: **Shishe, gotë dhe violinë**, teknikë e kombinuar



Vizatim kompjuterik

TË MBAJMË MEND:

Vizatohet me laps, thëngjill, shkumës me ngjyrë, pastel, tush, lapsa me ngjyrë. Ka vizatim kolazh, linear dhe abstrakt.

VIJA

Materialet e ndryshme lënë gjurmë të ndryshme gjatë të vizatimit, Gjurmët në sipërfaqe janë në formë vijash, të cilat kanë specifika të veta dhe karakter, në varësi se me çfarë materiali vizatohet. *Vijat mund t'i ndajmë si: të buta, forta, ngrohta, vrazhda, mprehta, shkurta, gjata, të trasha apo të holla.* Të gjithë këto së bashku e begatojnë vlerën figurative të vizatimit dhe kontribuojnë që shikuesi të kënaqet me llojlojshmërinë e tyre.

Albreht Direr: **Kalorësi**, laps

Vizatim me tush



Vija të buta



Vizatim me laps



Krijim nxënësi, tush



Vija sipas karakterë



Vizatim me thëngjill

Tome Serafimovski: **Nënë Tereza**, skicë**TË MBAJMË MEND:**

Gjatë të vizatuarit shprehemi me ndihmë të vijës.

TONI

Në vizatim, përveç vijës si mjet që më shpesh përdoret është toni. TONI arrihet me kombinimin e vijave dhe hapësirave duke treguar sipërfaqe të çelëta dhe të errëta, kalime gradacionesh nga e çelëta kah më e errëta, apo anasjelltas.

Tonin e arrimë me mbrojtje nga drita, me përforsim ose lëvarrje të vizatimit. Tani më, veçse u njohëm me këtë mënyrë të gradacionit tonik, ndërsa ato mund t'i shohim në ilustrimet që janë prezantuar.



De Segonzak: **Portret**, tush i derdhur



Vizatim lavarr



Vizatim me laps



Vizatim me përforsim



Vizatim lavarr



Sveto Manev: Start 1, laps me ngjyra (mbrojtje nga drita e errët dhe e çelët)

TË MBAJMË MEND:


Në vizatim përdorim tone të çelëta dhe të errëta. Tonet fitohen me mbrojtje nga drita, me përforsim dhe lëvarrje.

HAPËSIRA


Në klasat e mëhershme veçse jeni njoftuar me hapësirën si element i gjuhës figurative. Gjithçka që na rrethon është hapësirë reale. Në vizatim dhe vepra të tjera figurative, krijuesit kanë gjetur mënyra se si të fitojnë iluzion të hapësirës me përputhje, me dritë dhe errësirë, me forma të mëdha dhe të vogla.

Suksesin më të madh dhe prezantimin më i suksesshëm të hapësirës, krijuesit e kanë arritur përmes përdorimit të ashtuquajturës *perspektivë lineare*. Kjo perspektivë shpesh është përdorur nga krijuesit në kohën e Renesancës.

Në perspektivën lineare ekziston një vijë horizontale, e cila shënon horizontin, të cilën çdoherë kur shikojmë para vetes është në lartësi të syve, ashtu siç në horizont bashkohen qielli dhe deti, qielli dhe fushat. Perspektiva mund të paraqesim me një, dy ose me më shumë pika të përbashkëta, të cilat gjenden në vijën e horizontit, para nesh, majtas apo djathtas, ashtu siç mund të shohim në ilustrimet e mëposhtme.



Perspektivë




Perspektivë në natyrë




Perspektivë




Perspektivë linear me një pikë




Hapësirë me ton të çelët - të errët dhe me përputhje




Hapësirë me perspektivë



Perspektivë



Perspektivë lineare



Hapësirë me plotësim


Nëse përdorim perspektivë lineare me një pikë të përbashkët, ajo do të ndodhet pas nesh dhe gjithçka që është paralele me ne, ngadalë zvogëlohet dhe bashkëngjitet në atë pikë, për shembull, kur shikojmë rrugë, hekurudhë, etj.

Në rast se vizatojmë perspektiva me dy pika bashkimi, ato do të gjinden në të djathtë dhe të majtë të pikës së takimit, dhe të gjitha pikat tjera të horizontit do të bashkohen në ato dy pika, siç shohim në shembujt e paraqitur.

Nëse mundohemi, edhe ne vetë do të shohim shumë realisht një iluzion të hapësirës, respektivisht, iluzion të afërt dhe të largët, të brendshëm dhe të jashtëm.

Perspektiva paraqet shikim të gjërave rreth nesh, nga afër dhe larg, nga sipër dhe poshtë. Nëse në një vepër artistike shprehim diçka të cilën e shohim nga lartë, themi se kemi përdorur perspektivë zogu.

Nëse paraqesim diçka që e shohim nga poshtë, themi se ajo është prezantuar me perspektivë bretkose. Në art, shpesh takojmë vepra me perspektivë lineare, pasi nga kjo është lartësia e të shikuarit të njeriut.



Perspektivë me dy pika takimi

TË MBAJMË MEND:

Me perspektivë lineare më saktë paraqitet iluzion i hapësirës. Perspektiva ka horizont si dhe një, apo dy pika takimi.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

60

Në klasat e kaluara, me siguri kemi realizuar shumë vepra piktore, në teknika të llojlojshme nga kjo fushë figurative. Tani më mund të dallojmë çfarë është vizatim, pikturë, grafikë apo skulpturë.

Në pikturë është me rëndësi që artisti dhe të gjithë të tjerët t'i shprehin ndjenjat dhe emocionet e veta. Duke e shprehur veten e ndryshojmë realitetin për atë që shohim, ndërsa me atë bëjmë edhe vepra origjinale. Në krijimet figurative, autori vizaton dhe i ngjyros gjësendet me forma dhe ngjyra sipas dëshirës së vet. Me këtë bëhen fotografi magjike me shprehje të ndryshme.

Këtë pasuri të llojlojshme mund ta vërejmë te autorë të vendeve dhe epokave të ndryshme. Dallimi kryesisht shihet edhe në artin e popujve të ndryshëm dhe rajoneve të shumta gjeografike të botës. Sipas mënyrës se si janë krijuar, të njohura janë veprat e artit evropian, kinez, afrikan, egjiptian, arti i Majëve, Inkëve, si dhe arti i civilizimeve të tjera.

Secili nga këto arte ka dallime në mënyrën e paraqitjes së formës, dendësisë, ngjyrës, hapësirës dhe shprehje specifike artistike. E dimë që pikturohet me materiale dhe teknika të ndryshme në sipërfaqe të ndryshme. Sot, krijuesit përveç materialeve klasike, për pikturim përdorin edhe teknologjitë bashkëkohore, siç është kompjuteri, fotoaparati dhe video-kamera.



Paletë për pikturim



Vepër piktore nga mjeshtër kinez




Freskë egjiptiane



Thurje popullore

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV



Tomo Shijak: **Musandra**, teknikë e kombinuar



Dimitar Kondovski: **Bota e haruar**, teknikë e kombinuar



Kristo: **Galeri e paketuar** artistike, vizatim

Në artin figurativ bashkëkohor, krijuesit prezantohen edhe me objekt-pikturë, me intervenim figurativ në hapësirë, si dhe me hepening figurativ, që është një ndjenjë e veçantë për vizitorin bashkëkohor. Sot, nuk ekziston material prej të cilit nuk mund të bëhet pikturë. Ashtu si edhe në vizatim, artistët edhe në pikturë, rregullisht hulumtojnë dhe eksperimentojnë me materiale të ndryshme jo klasike, siç janë: materiale nga mbeturina të ndryshme, me aplikim, shtypje të sendeve dhe formave të ndryshme në pikturë, me përputhje, si dhe me veprime të tjera me qëllim të krijojnë vepra origjinale figurative.

Në këtë mënyrë, autorët i prezantojnë dhe i realizojnë idetë e tyre figurative. Përveç asaj që na rrethon dhe na jep ide për pikturim, shpesh inspirim për veprat mund të jetë dëgjimi i muzikës, nga libri i lexuar, shikimi i ndonjë filmi, apo të inspirohemi nga ndonjë vepër tjetër artistike. Shumë artistë të njohur janë inspiruar nga veprat e artit egjiptian, afrikan dhe kinez.



Petar Mazev: Pjesë nga mozaiku



Dushko Stojanovski: **Tapiceri**

TË MBAJMË MEND:

Në pikturë, çdoherë duhet të mundohemi të shprehemi në mënyrë origjinale. Dallojmë vepra artistike nga Evropa, Kina, Japonia, Afrika, Egjipti. Të njihemi me intervenimin, pikturë-objekt, hepening dhe të hulumtojmë me material të llojllojsh.

NGJYRA

Në krahasim me elementet tjera figurative, ngjyra ka rol kryesor në pikturë. Ajo është element themelor, përmes së cilës i shprehim idetë tona figurative, emocionet, gjendjen psikologjike dhe shijet estetike.

Në historinë e krijimtarisë artistike, pikturët, shpesh ngjyrën e kanë përdorur që ta shprehin gjendjen e tyre emocionale dhe psikologjike të njeriut. Me zgjedhjen dhe kombinimin e ngjyrave dhe formave kanë shprehur shqetësim, rezistencë, urrejtje, pakënaqësi, tronditje dhe kanë krijuar vepra në të cilat kanë dominuar atmosfera dramatike. Pikturat e tyre janë plot me emociione, në lidhje me ngjarjet, të cilat e kanë shqetësuar njeriun nga jeta e përditshme, siç janë: sëmundjet, tragjeditë, pasojat nga lufta apo katastrofa, sakrificat, etj. Përmes ngjyrës mund të shprehet tërë simbolika e jetës së brendshme psikologjike të njeriut.


Edvard Munk është piktor karakteristik që ka arritur ta paraqesë dramën e jetës së njeriut *përmes pikturës*.



Edvard Munk: **Loja e jetës**, vaj në pëlhurë (simbolika e ngjyrës)




Edvard Munk: **Shtëpia e kuqe**, vaj në pëlhurë (psikologjia e ngjyrës)



Anri Matis: **Enterier**, vaj në pëlhurë (psikologjia e ngjyrës)



Dragan Najdenovski: **Zonë 563**, vaj në pëlhurë



Vangel Koxhoman: **Motiv nga Prilepi**, vaj në pëlhurë

TË MBAJMË MEND:

Përmes ngjyrës mund t'i shprehim emocionet, gjendjen psikologjike të njeriut, gëzimin dhe pikëllimin.

TONI



Zhorzh Brak: **Grua**, vaj në pëlhurë, (ton kromatik)



Svetlin Rusev: **Zgjedhje e civilizimit**, vaj në pëlhurë, (ton akromatik)



Lubomir Popoviç: **Homazh për ser Xhemsin**, vaj në pëlhurë (çelës toni mol)



Rembrandt: **Orë nga anatomia**, vaj në pëlhurë (çelës toni dur)

TË MBAJMË MEND:

Nëse përdorim tone të njëjta, atë e quajmë çelës toni mol. Nëse përdorim tone kontraste, domethënë kemi përdorur çelës toni -dur.

KONTRASTI


Në të gjitha fushat e artit figurative, por edhe në pikturë, kontrastin e përdorim kur duam diçka të potencojmë, të veçojmë ose ta ndajmë formën prej formës në përmbajtje. Ndarja, respektivisht potencimin mund ta arrijmë me kontraste të ngrohta dhe ngjyra të ftohta, të çelëta ose errëta, ose me *kontrast të veçuar komplementar*.



Dimitar Manev: **Pikturë 1997**, vaj në letër (kontrast i çelët-errët)



Rozha de Suza: **Inventar i përditshtëm**, kontrast toni



Pablo Pikaso: **Naturë e vdekur**, vaj në pëlhurë (kontrast)



Kenet Kuc: **Spektri**, vaj në pëlhurë (kontrast i çelët-errët)



Emil Fila: **Naturë e vdekur**, vaj në pëkhurë (kontrast formash dhe i çelët-errët)




Andrijana Puleshi: **Pikturë**, vaj në pëlhurë (kontrast ngjyrash)

TË MBAJMË MEND:

Në pikturë përdorim kontraste të ngjyrave të errëta-çelëta, ngjyra të ngrohta-ftohta, si dhe kontrast komplementar.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

UNITETI



Rembrant: **Jakobi i bekon djemtë**, vaj në pëlhurë (unitet në ton)




Pjer Sulazh: **Pa titull**, vaj në pëlhurë (unitet në ton)




Viktor Vazareli: **Pa titull**, vaj në pëlhurë (me dominim të formës)



Dimitar Manev: **Pikturë 2000**, teknikë e kombinuar (unitet me ngjyrë dhe formë)



Radoslav Tadiq: **Në kopsht**, vaj në pëlhurë (unitet me teksturë dhe ton)



Xhekson Polok: **Mjegull në livandë**, vaj në pëlhurë (dominim të teksturës)

TË MBAJMË MEND: Uniteti arrihet me dominim të vijës, tonit, ngjyrës, formës, madhësisë dhe teksturës.


KOMPOZICIONI

Edhe në pikturë kompozicioni i bashkon të gjitha elementet në një tërësi. Në çdo fotografi mund ta dallojmë llojin e kompozicionit, të hapur, të mbyllur, gjysmë të hapur, diagonal apo piramidë. Përveç mënyrës së renditjes së elementeve në pikturë, mund të takojmë edhe kompozicione të cilat janë karakteristike sipas përdorimit të ngjyrës. Nëse përdorim ngjyra të forta dhe intensive, mund të themi se fotografia ka karakter koloriti. Me përdorimin e ngjyrave të buta arrijmë në përfundim se fotografia ka shenja lirike. Shpesh, disa artistë përdorin kombinim të ngjyrave të çelëta-hapura, buta apo të forta, të cilat shprehin dramaticitet të kompozicionit dhe ndikojnë në aspektin *psikologjik tek shikuesi*.



Francisko Goja: **Vrasje**, vaj në pëlhurë (kompozicion dramatik)

Modilani: **Gruaja e lakuriq**, vaj në pëlhurë (kompozicion lirik)



Karlo Kara: **Shenjtëri patriotike**, kolazh (kompozicion i hapur)



Vasilij Kandinski: **Në rrethin e zi**, vaj në pëlhurë (kompozicion i mbyllur)




FUSHAT E ARTIT FIGURATIV



Ogist Renoar: **Në ballkon**, vaj në pëlhurë (kompozicion lirik)



Edvard Munk: **Piskamë**, vaj në pëlhurë (kompozicion psikik-dramatik)




Pol Sezan: **Pisha dhe gurrëz**, vaj në pëlhurë (kompozicion vertikal)




Vepër e mjeshtrit kinez (kompozicion lirik)



Piter Brojgel: **Kulla e Babilonit**, vaj në pëlhurë (kompozicion piramidal)



Tome Mishev: **Para pasqyrës**, vaj në pëlhurë (kompozicion me kolorit)



TË MBAJMË MEND:

Përmes përdorimit të ngjyrës, fotografia mund të ketë karakter koloriti, lirik, dramatik apo karakter psikologjik.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

68

Tani më, veçse kemi njohuri për skulpturën si fushë specifike e artit figurativ. Të rikujtojmë se në skulpturë kemi vepra statike dhe të lëvizshme. Statike janë plastika e plotë dhe relief. Vepra të lëvizshme janë ato vepra që kohë pas kohe lëvizin në hapësirë, mekanike për shkak të rrymës së ajrit.

Materialet më të shpeshta të cilat përdoren për punimin e skulpturave janë: argjila, qeramika, metali, guri, bronzi, ndërsa në kohën më të re përdoren edhe *plastika, letra, materiale të ndryshme natyrore nga mbeturinat, stiropori, etj.*

Skulptori bashkëkohor çdo ditë eksperimenton dhe hulumton me materialet dhe mënyrat se si t'i kombinojë ato. Përdoren manifestime multimediale në të cilat kombinohen vepra nga fusha të ndryshme në një tërësi. Aplikohen dhe teknologji bashkëkohore audio-vizuale (televizor, video, kompjuter).

Çdo vepër skulpture fillon të realizohet sipas një ideje të caktuar të autorit. Sipas kësaj ideje, skulptori punon skica për pamjen e saj. Në varësi prej idesë, krijuesi i zgjedh materialet me të cilat do ta realizojë veprën e tij.



Boro Mitriqeski: **Portret i Marko Cepenkovit**, bronz



Tomo Shijak: **Musandra**, teknikë e kombinuar



Gligor Stefanov: **Grup objektsh**, teknikë e kombinuar



Aleksandar Kalder: **Saloni i kuq**, mobile



Dragan Popovski-Dada:
Gajdexhiu, gur



Zharko Baçeski: **Pa titull**,
silikon poliesteri, skulpturë

Në këtë fushë të artit figurativ, përveç shfaqjes së skulpturës në mënyrën klasike, krijuesit sot shprehen edhe me inovacione dhe projekte të ndryshme. *Me intervenim në hapësirë*, me ngjyra apo me skulptura dhe objekte, autori e ndryshon hapësirën, me çka e shpreh idenë e tij.

Çdo vepër skulpture, në varësi nga mënyra e punës është e konstruktuar me *kombinim, tretje, ridefinim dhe të ashtuquajturin kompozicion i disperzuar*.

Në sheshe dhe vende publike shpeshherë takojmë skulptura, të cilat paraqesin ngjarje historike, ose ndonjë personalitet të njohur, në madhësi natyrore, ose më të madhe. Këto objekte i quajmë *përmendore*. Përmes tyre i nderojmë këto ngjarje apo figura. Shpesh, përmendoret janë të bëra nga guri ose bronzi i derdhur, me çka kohëzgjatja e tyre është e pakufishme.



Ismet Ramiçeviq: **Pjesë e ekspozitës labirint**, material natyror

TË MBAJMË MEND:

Skulptura bashkëkohore punohet nga materiale të llojllojshme, ndërsa kombinohet edhe me arte të tjera.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

70

Skulpturat, më së shpeshti bëhen nga materiale të cilat janë stabile dhe të qëndrueshme ndaj kushteve klimatike. Shpeshherë, veprat e tilla bëhen nga *terakota, guri, druri, bronzi dhe metali*, por mund të punohen edhe nga plastika të ndryshme, letra, stiropori, si dhe materiale nga mbeturinat e ndryshme.

Mënyra e ndërtimit të një vepre të skulpturës është e llojllojshme, në varësi nga dëshira e autorit dhe zgjedhja e tij. Me argjilë modelohet përmes shtimit apo largimit, me dru dhe gur përmes thellimit apo marrjes, me metal dhe bronz për lëshim dhe ndërtim, përmes kombinimit dhe shtimit të formave, të cilat mes vete ngjiten apo saldohen.

Me plastikë, letër dhe stiropor, bëhet skulpturë përmes ngjities, mbështjelljes, prerjes dhe përformimit.



Petar Haxhi Boshkov: **Shkrime në formë**, terakotë



Ana Svetieva: **Lumi**, terakotë e ngjyrosur



Dimo Todorovski: **Duhanjelësit**, bronz



Dimo Todorovski: **Humnera**, bronz

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV



Gjoko Angelkovski: **Nëna me fëmijë**, gur



Aleksandar Ivanovski Karadaje: **Skulpturë II**



Krsto Slavkovski: **Vuajtje**, dru

Me materiale nga mbeturinat ndërtohet *asamblazh*, respektivisht skulpturë grupore, në të cilën kombinohen materiale të ndryshme, plotësisht sipas idesë së autorit.

Në skulpturë nuk ka kufizime për përdorimin e materialeve. Disa autorë shprehen duke kombinuar *rrënjë, degë, gur, bimë* dhe materiale të ndryshme, sipas zgjedhjes së autorit.



Petre Nikoloski: **Objekt XXXIII**, instalim



Përmendore e luftëtarëve të LNÇ

TË RIKUJTOJMË

Përveç skulpturave klasike, në skulpturë kemi edhe intervenim në hapësirë, asamblazh, instalim etj.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

72

NGJYRA

Njëra ndër elementet e artit figurativ, si pjesë e skulpturës, përveç dendësisë është edhe ngjyra. Shpesh skulptura nuk është plotësisht e ngjyrosur, por e mban ngjyrën e materialit nga i cili është punuar. Skulptorët, shpesh vendosin *patina* që të rruhet vepra, me çka në mënyrë minimale ndryshon ngjyra e tyre, e veprave të skulpturës me *patina*, me kalimin e kohës dhe nën ndikimin e kushteve atmosferike. Ky ndryshim me patinë është karakteristike vetëm për veprat që vendosen në hapësirë të hapur.

Përveç *patinimit* nga ana e autorit dhe patinimit nën ndikimin e motit, shumë skulptorë i ngjyrosin veprat e tyre. Përdorimi i ngjyrave bëhet që nga koha parahistorike, tek disa civilizime të vjetra, siç janë, ajo e *Egjyptit*, *Kinës*, *Greqisë*, *Romës*. Në skulpturën moderne, ngjyra përdoret shumë shpesh, për ta plotësuar idenë e autorit dhe mendimin estetik të tij.



Hyjnesha e gjarprit, terakotë e Iyer



Monedhë e vjetër me patinë



Statujë kineze, qeramikë e Iyer



Princi Rahotep dhe gruaja e tij Nofret, gur gëlqeror i Iyer, Egjipt



Sende nga ari, argjendi dhe druri, Mesopotami



Artist nga Hopeh: Statujë e Arhatit, qeramikë e Iyer



Jordan Grabuloski: **Shenja hapësinore**, çimento



Mobil



Marieta Sidovska: **I am looking for a man in the mirror**, teknikë e kombinuar




Vlado Avramçev: **numër 11**, qeramikë



Vasil Vasilev: **Formë asociative vertikale XXXII**, dru



Pablo Pikaso: **Portret**, teknikë e kombinuar



Huam Miro: **Skulpturë**



Krijim nxënësi nga letra



Origami

TË MBAJMË MEND

Patina është ndryshimi i ngjyrës së sipërfaqes së skulpturës nën ndikimin e diellit, errës, shiut apo të ekspozuar në hapësirë të jashtme. Me patinim, vepra duket si skulpturë nga e kaluara.


Nga klasat e mëhershme e dimë që grafika si pjesë e artit figurativ i ka specifikat e veta, në mënyrën e krijimit të gjërave. Të gjitha veprat tjera janë origjinale atëherë kur bëhen në një ekzemplar. Në grafikë shtypen më shumë shenja të njëjta, të cilat kanë vlerë të njëjtë si origjinali, në qoftë se nënshkruhen nga autori.

Veprat *grafike shtypen* me dorë apo me presë për shtyp. Ekzistojnë disa lloje të shtypit: *i thellë, i lartë, i rrafshët, i lëshuar dhe shtyp i kombinuar*, e që varet nga përpunimi i materialit.

Nëse ngjyra e lëshuar në pllakë, respektivisht, klisheja lëshohet në hapësirat e sipërme, në pjesët e larta, atëherë kemi shtyp të lartë.

Në këtë shtyp bën pjesë edhe *shtypja e kartonit, linogdhendja, drugdhendja si dhe gjipsgdhendja*. Nëse ngjyra shtypet në pjesën e brendshme të klishesë, atëherë kemi shtyp të thellë, ku bëjnë pjesë edhe *gdhendja e bakrit, akuatinta dhe gjylpëra e thatë*.

Kur matrica e pllakës është e rrafshët, ndërsa mekanikisht edhe kimikisht nuk është e thellë, kemi shtyp ku bën pjesë *litografia*.




Makinë për shtyp



Mjet për gdhendje të metalit, klishe

Alfred Hrdmička: **Kompozicion**, gdhendje në bakërIlija Kočovski: **Bukuroshja dhe përbindëshi**, drugdhendje në ngjyrëLadislav Cvetkovski: **Grafikë kompjuterike**



Monotip



Petar Haxhi Boshkov: **Grafikë I**, litografi



Vepër nxënësish, lino gdhendje

Shtypi me teknikën sito bën pjesë në shtypin e lëshuar, për shkak të hapësirës së rrafshët, të butë të matricës lëshon ngjyrë gjatë shtypjes në grafikë.

E mbajmë mend, se në klasën e pestë u njohëm me procesin dhe procedurën e shtypjes së letrës grafike, si dhe me atë se si nënshkruhet nga autorit. Me siguri keni bërë krijime artistike nga fusha figurative e grafikës. Krijuesit, me punën e tyre, përveç procedurave klasike për shtypje, shpesh *hulumtojnë dhe eksperimentojnë* me materiale të tjera, si dhe përdorin teknologji bashkëkohore, siç është *kompjuteri*.

Në klishe, respektivisht në klishe për shtypje, artistët shpesh ngjisin materiale të llojllojshme, me tekstura interesante. Duke vendosur ngjyrë në këto materiale para shtypit, përfitohen gjurmë grafike interesante, të cilat do të fitoheshin me thellim. Secili prej nesh mund të mundohet, gjithashtu edhe ju me ndihmën e arsimtarit, kreativitetin tuaj mund ta shprehni me eksperimente të reja.



Vepër nxënësish, monotip

TË MBAJMË MEND:

Dallojmë shtyp të thellë, të lartë, rrafshët, të lëshuar dhe të kombinuar. Që të përfitohet teksturë e shumëllojshme, në klishe mund të shtypet edhe me ngjitje në hapësira të tjera të ndryshme.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

76

Sot, shumë artistë të grafikës e përdorin *kompjuterin* si mjet për përpunimin e grafikës bashkëkohore. Duke përdorur programe kompjuterike mund të përpunohen shumë lloje grafike, të cilat janë shtypur dhe nënshkruar nga autori dhe paraqesin vepra origjinale.

Gjatë përpunimit të grafikës me kompjuter, artisti mund të realizojë pakufi versione në një grafikë, në një ide duke i *ndryshuar ngjyrat, tonet dhe kombinimin e formave*.



Hans Balding:
Kalorësi i magjepsur, gdhendje në bakër



Burhan Ameti: **Spirit**, grafikë digjitale



Pablo Pikaso: **Profil femre**, gjilpërë e thatë

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV



Dragutin Avramovski **Gute**: lino gdhendje

Nëse duam letrën grafike ta vendosim në shtëpinë tonë, apo ta ekspozojmë në galeri, duhet paraprakisht ta *pajisim*, respektivisht ta vendosim në kornizë. Grafika çdoherë vendoset nën qelq, i cili mund të jetë i thjeshtë apo *qelq antirefleksues*.


Mënyrë tjetër e ekspozimit të veprave grafike është që fletët të vendosen midis dy qelqeve dhe të ekspozohen në galeri. Në këtë mënyrë, letrat grafike hiqen lehtë dhe pastaj ruhen në fascikla.



Alen Kushkureviq: **Hulahopa**, gjilpërë e thatë



Fehim Huskoviq: **Takim në vetmi**, shtyp me teknikë sito



Frider Nake: **Grafikë kompjuterike**



Vepër nxënësi, shtyp kartoni



Pablo Pikaso: **Portret**, drugdhendje me ngjyrë

TË MBAJMË MEND

Kompjuteri është mjet më bashkëkohor për punimin e grafikës kompjuterike.

TONI


Në grafikë, vlera më e shpeshtë shprehet përmes vijave, tonit dhe teksturës.

Toni arrihet me gradacion të ndriçimit nga e errëta kah më e çelëta ose me rastër.


Rastëri arrihet me përdorimin e vijave të llojllojs-hme, me kombinim paralel dhe të kryqëzuar, më shpesh ose më rrallë, me çka arrihet efekt i sipërfaqeve më të errëta dhe më të çelëta.



Rembrant, Shkrim në bakër (i errët dhe i çelët)



Lloje rasti në grafikë



Rastër



Lloje vijash



Lloje rastëri

TË MBAJMË MEND:

Me përdorimin e rastërit fitojmë tone të llojllojs-hme në grafikë.

LITOGRAFIA



Të punuarit me gur litorafik



Francisko Goja, **litografi**



Edvard Munk: **Mëkati**, litografi

Litografia është teknikë e grafikës në shtyp të rrafshët. Emri rrjedh nga fjala greke *lithos-gur dhe grap-ho –shkruaj*.

Guri që shërben si klishe duhet të jetë i rrafshët, vizatohet me shkumës special, tush litografik, ose në mënyrë të kombinuar. Me rëndësi është që *shkumësi dhe tushi* të jenë të yndyrshëm dhe të lëshojnë gjurmë yndyre në gur. Pastaj, mbi gur lëshohet acid, i cili e gërryen gurin në ato vende ku nuk ka yndyrë. Vendoset *gomë arabike*, me çka vizatimi forcohet. Shtypet duke vendosur ngjyrë litografike, e cila mbetet në vendet e yndyrshme ku më parë është vizatuar në gur me shkumës ose me tush.

Litografia shtypet me presë të veçantë litografike. Me shkumës fitohet shkallë e gjerë e valerive (toneve) nga gri e zbehtë deri te ngjyrë e zezë e plotë, me çka vizatimi fiton plasticitet të shprehur.

Litografia mund të jetë e bardhë apo e zezë, por edhe me shumë ngjyra. Nëse bëhet grafikë me më shumë ngjyra, për secilën ngjyrë përdoret procedurë e gurit të veçantë, ndërsa të gjithë shtypen në një fletë.



Pablo Pikaso: **Huti**, litografi



Tuluz Lotrek: **Pllakat**, litografi

TË MBAJMË MEND:
Litografia është shtyp i rrafshët. Klisheja është pllakë e cila përpunohet kimikisht, në të cilën vendoset ngjyrë dhe me presë litografike shtypet grafikë.

SHTYPI ME TEKNIKË SITO

Shtypi me teknikën sito është teknikë e shtypit të lëshuar. Ajo mundëson përpunim të një numri të madh shënimesh. Vetë emri e sqaron këtë teknikë. Përdoret një rrjetë e shpeshtë (sitë) dhe klishe e përshtatshme (shabllon).

Shtypi me teknikë sito realizohet në mënyrë të këtillë: Në kornizë të drunjtë apo metalike vendoset sitë nga mëndafshi. Në sitë vendoset *emulzion i fotondjeshëm*, në të cilin me procedurë të veçantë paraqiten *hapësira të kalueshme dhe pakalueshme*. Shtypet me dorë, me tërheqjen e ngjyrave me *rakel*, në mënyrë të barabartë në tërë hapësirën e sitës, me çka ngjyra nëpër vrima kalon në letrën grafike.


Karakteristika të shtypit me teknikën sito janë: *ngjyra dhe vija e qartë, hapësira e madhe, rastër, hapësirë për përputhje të ngjyrave dhe formave*. Kjo teknikë mundëson shtypin e formateve të mëdha, veçanërisht përdoret në kohën e *artit të stilit pop*.




Rakël shtypi



Mjete për shtyp




Procesi i shtypit




Procesi i shtypit



Grafikë, shtyp-sito

Stanko Pavleski:
Në burimin e krijuesve
vizuel, shtyp-sitePetar Mazev:
Pa titull, shtyp-sito

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV



Dimitar Malidinov:
Pa titull, Shtyp-sito



Risto Kaçevski: **Pa titull**,
Shtyp-sito



Vele Tasheski: **Nga natyra**,
Shtyp-sito




Zoran Jakimovski:
Forma HH, Shtyp-sito



Dimitar Kondovski: **Hijet**, Shtyp-
sito



Rodolub Anastasov: **Njeriu
dhe hapësira**, Shtyp-sito



Dimçe Nikolovski:
Zonë 17, Shtyp-sito

TË MBAJMË MEND:

Shtypi-m teknikën sito është teknikë e shtypit të lëshuar. Ngjyra kalon nëpër hapësirat e lëshuara të sitës, e cila është klishe për shtypje. Ngjyra vendoset me rakël.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

82

Dizajni dhe komunikimet vizuale janë fusha specifike të artit figurativ të përhapura më së shumti në botë. Çdo ditë ndeshim dhe përdorim prodhime të dizajnuara nga *dizajnuet artistik*.

Nëse sot shikojmë ndonjë prodhim të bërë pesëdhjetë ose njëqind vjet më pare dhe bëjmë krahasimin me prodhimet e sotme, ajo mund të jetë e pazakontë dhe interesante. Dizajni dhe komunikimet vizuale zhvillohen dhe bëhen më moderne dhe më bashkëkohore. Kur formësohet pamja e ndonjë sendi për përdorim të përditshëm, i cili prodhohet në industri, themi se është *dizajn industrial*. Në punimin e gjësendeve të vjetra të artizanatit, gjithashtu hasim dizajn.

Tek ne kemi përpunim të sendeve nga ari dhe argjendi, që e hasim tek *argjendarët dhe bakërgdhendësit*, ndërsa më i njohur është përpunimi i *filigranit*.

Dizajnuetit grafikë merren me formësimin e materialeve për shtyp për përdorim të përditshëm, për lexim, për informim apo reklamim. Në këtë bëjnë pjesë edhe krijimi i pamjes së ambalazheve të ndryshme, *kornizave dhe ilustrimeve për libra, reklamave, fletushkave, posterëve, pllakateve, billboardëve*, si dhe spoteve apo videoklipeve të ndryshme reklamuese. Në dizajnin grafik, krijuesit mundohen t'u japin pamje tërheqëse dhe estetike përmes përdorimit të efekteve figurative dhe dekorimeve të ndryshme.

Përdoren lloje të ndryshme të shkronjave dhe zbukurimeve. Në të kaluarën, në tekstet e ndryshme për zbukurime, me *inicialet, vinjeta, rozeta dhe logo* të ndryshme.

Në dizajnin grafik, më së shumti punohet me përdorimin e fotografisë dhe kompjuterit. Nuk ka dizajn grafik në të cilin nuk është i përfshirë kompjuteri si element themelor për punë.



Filigran



Filigran



Kapëse me filigran



Kapëse me filigran



Filigran



Filigran



Vepër e punimit me argjilë

Kostumografët janë krijues të artit figurativ, të cilët dizajnojnë pamjen e veshjeve, ndërsa dizajnuesit janë artistë të cilët krijojnë idenë e dezenimit të pëlhurës së veshjes. Shikuar historikisht, kostumi çdoherë ka qenë karakteristik për popuj, periudha dhe profesione të ndryshme. Kostumi gradualisht ka ndryshuar, nga kohët më të hershme deri më sot, në veshjen bashkëkohore.

Për shfaqjet teatrore dhe filmike dizajnohen kostume specifike, të cila varet nga koha se kur zhvillohet ngjarja, si dhe nga karakteri i personaliteteve të cilët marrin pjesë në skenë. Këtë lloj e quajmë *kostum ske-nik*.



Filigran



Filigran



Filigran

TË MBAJMË MEND:

Dizajnuesit janë artistë të cilët i japin formë prodhimit dhe produkteve të ndryshme. Dallojmë, dizajn industrial dhe grafik. Kostumografët dhe dizajnuesit dizajnojnë formën dhe desenin për veshje.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

84

ARTIZANATET E VJETRA

Në Maqedoni kemi artizanate, të cilat me duar dhe me shumë shije kanë formësuar sende zbukuruese. Janë të njohur argjendarët dhe bakërpunuesit e vjetër, të cilët edhe sot e kësaj dite krijojnë stoli, të cilat quhet *filigran* i përpunuar prej *bakri dhe argjendi*.



Filigran i njohur maqedonas



Makinë e vjetër shkrimi



Karrocë e vjetër për fëmijë 1919



Televizor



Gramafon

TË MBAJMË MEND:

Argjendarët dhe bakërpunuesit janë mjeshtër të artizanateve të vjetra në Maqedoni, të cilët kanë krijuar stoli të arit dhe argjendit. Stolia më e njohur është filigrani dhe pjesë nga veshjet popullore.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

DIZAJNI INDUSTRIAL


Formësimi i sendeve për përdorim të përditshëm quhet *dizajn industrial*. Me kalimin e kohës, pamja e re ka ndryshuar në një pamje më të bukur dhe më moderne. Shikoni sendet e dizajnuara në të kaluarën, si janë dukur atëherë dhe si duken tani.



Ndriçues



Karrige



Sanitari



Karrige



Karrige



Vetura

TË MBAJMË MEND:
Dizajni industrial i dizajnon sendet të cilat prodhohen për përdorim nga njeriu.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

86

KOSTUMOGRAFIA

Si do të duket veshja jonë, varet shumë nga ajo se si e dizajnojnë artistët të quajtur dizajnues të modës. Një fushë e veçantë në dizajnimin e veshjes është ajo e dedikuar për filmin dhe teatrin. Këto *dizajnues* i quajmë *kostumografë*. *Kostumografët* e njohin zhvillimin historik të kostumit dhe si të tillë e krijojnë për çdo shfaqje teatrore apo film, në varësi nga koha se kur ka ndodhur ngjarja.



Kostum historik - Evropë



Kostum historik – Francë



Kostum historik-Egjipt



Kostum historik-Greqi



Kostum historik-Bizant

TË MBAJMË MEND:
Dizajnuesit e modës janë artistë, të cilët meren me dizajnimin e veshjeve të reja dhe moderne.


FUSHAT E ARTIT FIGURATIV



Dizajn industrial



Dizajn industrial



Dizajn industrial



Dizajn industrial



Dizajn industrial

DIZAJNI INDUSTRIAL

Gjithçka që dizajnohet dhe mandej shtypet në shtypshkronjë është dizajn grafik. Këta artistë i quajmë dizajnerë të grafikës. Ata dizajnojnë pamjen e ndonjë ambalazhe të ndonjë prodhimi për përdorim të përditshëm, *pamjen e gazetave, magazinave, librave, pllakateve, reklamave dhe ilustrimeve.*



Dizajn industrial




Kopertinë libri

TË MBAJMË MEND:
Dizajnuesit grafik janë artistë, të cilët e bëjnë pamjen e gjithë asaj që lexojmë apo na informon.

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

88



Ilustrim




Ilustrim



Ilustrim



Ilustrim



Pllakat



Pllakat



Pllakat



Shenjë mbrojtëse (Logo)



Shenjë mbrojtëse (Logo)



Shenjë mbrojtëse (Logo)



Shenjë mbrojtëse (Logo)

FUSHAT E ARTIT FIGURATIV

SHENJA - LOGO



Stema e Republikës së Maqedonisë

Secili prodhues, i cili dëshiron të bëhet i njohur, kur blihet produkti i tij e ka *shenjën mbrojtëse*, të cilën e quajmë *logo*. Ka shumë prodhues të veshjeve, ushqimit, automobilave, kozmetikës, etj. ,të cilët i njohim sipas logos së tyre, siç janë: Mekdonalds, najk, mercedes, shenja e Supermenit dhe shumë të tjera. Këto shenja i qujmë shenja mbrojtëse pasi të tjerët nuk kanë të drejtë t'i përdorin dhe janë të mbrojtura me ligj për të drejtat e autorit.



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)



Shenjë mbrojtëse (logo)

TË MBAJMË MEND:

Logoja është shenjë vizuale mbrojtëse e prodhuesit. Përmes logos njihet, vlerësohet dhe blihet prodhimi.


ARTI FIGURATIV

Vepër artistike e quajmë çdo vepër të krijuar nga njeriu, e cila ka vlerë artistike. Vlerat e veprës artistike vlerësohen nga kualiteti që është shprehur përmes gjuhës së artit figurativ, respektivisht vijës, ngjyrës, formës, tonit, dendësisë, etj.

E dimë që estetika është shkencë për studimin e së bukurës. Përmes teorisë së estetikës vlerësohet një vepër. Vlerësimin estetik e bëjmë përmes bisedës në lidhje me kualitetin e asaj që shohim, artisti ose ne siç jemi shprehur artistikisht, me çfarë teknikash e kemi realizuar një vepër artistike, çfarë ndjenjash ajo ngjall tek ne. Pot-huajse më e rëndësishme është sa ajo vepër është origjinale dhe me çka dhe sa dallohet nga veprat tjera.

Me ndihmën e arsimtarit të lëndës së arsimit figurativ, nxënësit bëjnë bisedë për vlerësimin estetik të një vepre konkrete, vizatim, grafikë, skulpturë ose ndonjë shembull për komunikim vizual ose dizajn.

Përmes vlerësimit estetik mundohemi t'i shohim dhe t'i theksojmë problemet e artit figurativ dhe karakteristikat e asaj vepre.



SHEMBULLI 1

Ordan Petleski, monument, vizatim

Nëse në këtë periudhë kemi mësuar për harmoninë si parim figurativ, si shembull për vlerësim estetik do të marrim veprën e e Ordan Petlevskit. Duke e shikuar këtë vizatim mundohemi që t'i shohim vlerat e tij më karakteristike. Përmes pyetjeve dhe përgjigjeve konstatojmë se:

-Kjo vepër është vizatim, e punuar me tush dhe percë dhe ka karakteristikat e vizatimit lavar.

-Artisti është shprehur me përdorimin e vijave të shumëllojshme dhe kombinime të shumta, të pasuruar me teksturë të shumëllojshme.

-Në vizatim vijat dhe format janë të ngjashme, me çka është arritur harmoni në vepër.

- Vërejmë se vizatimi është prezantuar në mënyrë të qartë dhe precize.

- Duke e analizuar vizatimin ne mund individualisht të gjejmë asociacione të cilat varen nga fantazia jonë.



Ordan Petleski, **monument**, vizatim

SHEMBULLI 2

Vasilij Kandinski, Disa rrathë, vaj në pëlhurë

Në orën e arsimit figurativ, përveç veprave të tjera mund të vendoset edhe vepra e Vasilij Kandinski, për shikim dhe vlerësim estetik. Duke e shikuar fotografinë mundohemi të vërejmë se cilat karakteristika i ka kjo vepër.

- Konstatimi i parë është se kjo pikturë edhe sipas legjendës është e bërë me teknikën e vajit.

- Përshtypje e parë është kontrasti i ngjyrave të çelëta dhe të errëta, si dhe madhësia e formave. Rrethet e bardha dallohen nga sfondi me çka asocion ndjenjë të afri-së dhe largësisë, respektivisht, japin iluzion të hapësirës. Rrathët e vogla, të cilat janë me ngjyrë më të çelët na duken më larg se të mëdhatë. Rrethet e ngjyrosura, në varësi nga ngjyra e tyre, disa duken më afër, ndërsa disa më larg. Iluzion të hapësirës na japin rrathët, të cilët janë të vendosur me përputhje.

- Format e njëjta, në të njëjtën kohë duken të harmonizuara në pikturën si tërësi.

- Duke e shikuar pikturën në tërësi, secili prej nesh, sipas fantazisë së vet, mund të vijë në një mendim se në çfarë e asocion kompozicioni si tërësi.



Vasilij Kandinski, **Disa rrathë**,
vaj në pëlhurë

SHEMBULLI 3

Pablo Pikaso, Portret, drugdhendje me ngjyra

Duke e shikuar grafikën e Pablo Pikasos do t'i vërejmë këto vlera:

-Kjo grafikë është e bërë në drugdhendje, gjë që shihet në kufijtë e mprehtë midis ngjyrave dhe gjurmëve të daltës me të cilën është punuar klisheja për shtyp.

-Grafika është me më shumë ngjyra, me çka konstatojmë se autori për secilën ngjyrë ka përgatitur klishe të veçantë nga druri.

-Format e grafikës janë të qarta dhe të njohura, të ndara nga njëra tjetra, dhe i gjithë portreti është vendosur në një prapavijë të ndritshme, me çka lë përshtypje të madhe tek shikuesi.

-Vijat dhe format duken të lëvizshme dhe dinamike.

-Ngjyrat janë të ngjashme dhe harmonike, ndërsa ngjyra e zezë përdoret që t'i potencojë karakteristikat e personalitetit.

-Duke shikuar veprën, ne dallojmë mënyrën origjinale se si shprehet Pablo Pikaso.




Foto 1: Pablo Pikaso, **Portret**, drugdhendje me ngjyra

SKULPTURË

SHEMBULLI 4

Dimo Todorovski, Humnera, bronz

Nëse mundohemi ta analizojmë skulpturën e artistit Dimo Todorovski, mund të vërejmë se:

-Kjo vepër është skulpturë dhe bën pjesë në plastikë të plotë, pasi që mund ta shohim nga të gjitha anët. Është e lyer me bronz dhe e patinuar me ngjyrë të zezë.

-Artisti ka përdorur forma dhe madhësi të ndryshme, me çka konstatojmë se skulptura është me vëllim të komplikuar. Vëllimi është shpesh me forma rrethore, kështu që e tërë vepra duket harmonike.

-Skulptura është realiste. Përmes motivit mund ta ndjejmë tragjedinë dhe vuajtjet e njerëzve, respektivisht atë që autori ka dashur ta shprehë përmes kësaj skulpture.



Dimo Todorovski, **Humnera**, bronz

SHEMBULLI 5

Stema e Republikës së Maqedonisë

Logo është shenja mbrojtëse e ndonjë produkti, ndërsa stema e Republikës së Maqedonisë paraqet simbol të shtetit. Flamuri gjithashtu është shenjë apo simbol i njohur i ndonjë shteti.

Artisti që e ka krijuar stemën e Republikës së Maqedonisë, në të ka paraqitur shumë elemente, me të cilat ka dashur që t'i paraqesë karakteristikat e vendit. Nga stema mund të konstatojmë:

- Maqedonia është shtet i pasur me male, liqene, fusha dhe dritë dielli.
- Maqedonia është vend pjellor, me karakteristik është kultivimi i prodhimeve bujqësore, nga të cilat në semë janë të paraqitura malet, gruri dhe afioni.
- Simbolet e paraqitura në stemë janë të thjeshta dhe të stilizuara, gjë që është karakteristike për të gjitha stemat e qyteteve dhe shteteve në botë.



Stema e Republikës së Maqedonisë

GALERIA

E VEPRAVE NGA ARTI FIGURATIV

96

Këta shembuj të veprave nga arti figurativ, do të na mundësojnë që të bëjmë vlerësim të pavarur estetik.

VIZATIM



Ordan Petleski



Tanas Lulovski



Vasko Tashkovski



Leonardo da Vinçi



Vinsent van Gog



Pablo Pikaso



Hans Hartung



Raul Difi



Anri Matis



Dejvid Hokni



Tulluz Lotrek



Piter Brojgel



Andreja Mantenja



Kuang Kai




Albreht Direr



Edgar Dega



Rembrant



Leonardo da Vinçi

GALERIA

E VEPRAVE NGA ARTI FIGURATIV

PIKTURË



Sveto Manev



Tomo Shijak



Jovan Shumkovski



Dimitar Manev




Vladimir Gjorgjievski



Risto Kalcevski



Blagoja Nikolovski



Vangel Koxhoman



Rubens Korubin



Vangel Naumovski



Mozaik dyshemeje, Heraklea



Dimitar Kondovski



Dushan Perçinko



Miroslav Masin



Ana Temkova



Tanja Balaq



Mikica Trujkanoviç



Lazar Liçenoski



Petar Mazev



Vasko Tashkovski



Nikolla Martinovski



Dimitar Pandilov



Ilija Kočovski



Reshat Ameti



Tanas Lulovsk



Simon Shemov



Konstantin Kalaçev



Vinsent van Gog




Mjeshtëtër japonez



Mark Shagal



Endi Vorhold




Viktor Vazareli




Vasilij Kandinski



Pit Mondrijan




Salvador Dali




Ogist Renoar



Kristo




Pol Kle



Pablo Pikaso



Huan Miro



Anri Matis



Freskë egjiptiane

GALERIA

E VEPRAVE NGA ARTI FIGURATIV

10

99



Ezen de la Kroa



Pol Gogen



Edgard Dega



Gustav Kurbe



Klod Mone

SKULPTURË




Petar Haxhi Boshkov



Stefan Manevski



Zharko Basheski



Ismet Ramiçeviq



Tomo Shijak



Stanko Pavleski



Petre Nikollovski



Tome Serafimovski



Gligor Stefanov



Ibrahim Bedi



Dimo Todorovski



Dragan Popovski-Dada



Jordan Grabulovski



Vasil Vasilev



Marsel Dushamp



Kinë




Pablo Pikaso



Mikelanxhelo



Konstantin Brankusi



Eduardo Paloci



Aleksandar Kalder



Dushan Xhamonja



Indi



Branko Veliçkovski




Henri Mur



Umberto Boçoni



Ivan Meshtroviq



Romë

GALERIA

E VEPRAVE NGA ARTI FIGURATIV



Franjo Krčinić




Romë



Krsto Slavkovski



Romë



Simon Shemov



Riso Kalčevski




Dimitar Malidanov



Dimče Nikolov



Dragutin Avramovski



Endi Vorhold




Burhan Ameti



Francisko Goja



Pablo Picasso



Edvard Munk



Rembrandt



Albrecht Direr



Tuluž Lotrek

A

Amator –adhurues i artit, i cili ka profesion të vet, por merret me krijimtari artistike nga dashuria, e jo profesionalisht.

Ambalazh – Dizajnim figurativ i materialit, në të cilin materiali paktohet dhe shitet prodhimi.

Animalist - artist figurativ, i cili posaçërisht merret me paraqitjen, respektivisht pikturimin, ose skulpturimin e kafshëve.

Antikë-emërtim i kulturave të vjetra, veçanërisht të kulturës romake dhe greke.

Arabeskë – ornament i mënyrës arabe, i cili përbehet nga elemente të stilizuara gjeometrike dhe bimore.

Art abstrakt - drejtim në artin modern i cili e braktis paraqitjen e botës reale dhe krijon me formë.

Art aplikativ - emërtim i sendeve të formësuar në mënyrë artistike për dedikim të përdorshëm.

Art figurativ - emërtues i përbashkët për arkitekturën, pikturën, skulpturën dhe grafikën, vepra të cilat njeriu i krijon në mënyrë kreative.

Atelie - punëtori e krijuesit artistik, ose personit për profesione kreative.

B

Barelief – relief shumë i cekët dhe i ulët në skulpturë.

Bienale - ekspozitë e cila mbahet çdo të dytin vit.

Bust – paraqitje e kokës dhe pjesës së sipërme të trupit të njeriut në skulpturë.

D

Dekorim – zbukurimi i hapësirës, si dhe formave të veçanta të zbukurimit.

Dizajn - vizatim i dedikuar, zbukurim i prodhimit për prodhimtari industriale.

Dizajn industrial- Formësim artistik i sendeve për përdorim të përditshëm, të cilat prodhohen në mënyrë industriale.

Dizajnuet - artist, specialist për formësim estetik të sendeve ose hapësirave për prodhimtari industriale.

F

Fakturë - sipërfaqja e veprës artistike në pikturë, me të cilën fitohen disa veti në sipërfaqe.

Figurativ – karakteristike e ndonjë vepre artistike kur në të mund të dallohet ndonjë personalitet konkret, përmbajtje apo motiv.

G

Galeri – hapësirë e ndërtuar me dedikim për të ekspozuar vepra artistike.

Grafikë reproduktive- kopje ose vepra të cilat nuk janë të shtypura me dorë, por me shtyp *offset industrial*.

Guash – teknikë për vizatim me ngjyra uji ose me temperë të bardhë.

H

Histori e artit - shkencë për paraqitjen dhe zhvillimin e drejtimeve artistike, vlerave dhe rëndësinë e tyre historike.

Lj

Ilustrim – pikturë apo vizatim i lidhur me veprimin e tekstit të shkruar.

L

Letër grafike – Vepër artistike e shtypur grafikisht.

Linear - karakteristikë e pikturës, skulpturës apo ndonjë vepre grafike në të cilën mjet kryesor është vija.

Iluzion - iluzioni në pikturë është paraqitja e hapësirës, tonit, perspektivës, etj.

K

Katalog - Publikim në të cilin janë regjistruar të gjitha veprat e ekspozuara në muze, galeri, ekspozitë ose veprimtaritë e artistit.

Kiç - produksion apo artizanat joartistik. Kiçi krijohet për shkak të dëshirës së lirë të pëlqimit, do të thotë avancim i pëlqyer për artin, ndërsa krijohet si rezultat i mjedisit të pazhvilluar artistik.

Kolorit – ngjyrosje, veçori, shprehje, efekt i veprës artistike i cili arrihet me ngjyra.

Krokë - vizatim i shpejtë dhe i lehtë me vija të thjeshta dhe pak detaje

M

Marinë - Paraqitje artistike e peizazhit detar.

Miniaturë - pikturë apo skulpturë e shprehur në format të vogël.

Mbështjellës - Formësim figurativ i kornizës së librit apo ndonjë materiali tjetër reklamues.

Monografi - libër në të cilin në mënyrë të përpiktë paraqitet jeta dhe krijimtaria e ndonjë artisti.

Monokromi - vepër skulpture e punuar vetëm me një ngjyrë.

Mozaik - vepër artistike e cila përpunohet me bashkimin e kubeve të qelqit, gurit me ngjyra të ndryshme etj.

N

Natyralizëm – orvatje e artit, që dukuritë dhe objektet i paraqesin të vërteta dhe reale.

Ngjyrë lazure - Shpërndarje e tejdukshme e ngjyrës nëpër të cilën mund të shihet bazamenti.

O

Ornament – format gjeometrike bimore, bimore ose zoomorfe, me të cilat është zbukuruar ndonjë sipërfaqe, të cilat mund të përsëriten.

P

Paletë - sipërfaqe në të cilën piktori i përziën ngjyrat para se të fillojë t'i vendos në vepër.

Panoramë – paraqitje e hapësirës me horizonte të gjëra dhe të largëta.

Peizazh - pikturë në të cilën paraqitet natyra.

Profil – pamje anësre e fytyrës së ndonjë sendi apo njeriu.

S

Signaturë - nënshkrim me dorën e vetë artistit në pikturë, grafikë ose skulpturë, të cilën e ka punuar ai.

Skicë - pikturë, skulpturë apo ndërtim fillestar, i bartur dhe i parregulluar.

Stilizim - thjeshtësim, bërje të formave natyrore në madhësi të thjeshta dhe themelore.

Skulpturë galerike -Skulpturë e cila sipas madhësisë së saj mund të ekspozohet në galeri (madhësi reale ose miniaturë).

Sh

Shtafelaj - mbajtëse pikturë, këmbëza në të cilën artisti vendos pikturën gjatë punës.

Shtyp i rrafshët – teknikë grafike pa thellime në bazament (Shtyp-sito, monotipi, litografi).

T

Tapiceri - emërtim i përgjithshëm i veprës artistike të punuar nga materiali i tekstilit.

Terakota - emërtim i përgjithshëm për prodhimet e argjilës të cilat forcohen me pjekje.

Triptik - vepër artistike e përbërë nga tri pjesë.

V

Valer – Fjalë adekuate franceze për tonin.

Vinjetë – vizatim apo pikturë e vogël e cila përdoret si zbukurim në çdo tekst.

Vitrinë – dritare apo hapësirë e qelqtë, e krijuar ose e zbukuruar me pjesë qelqi nga ngjyra të ndryshme.

Vizatim - vepër artistike në sipërfaqe, ku vija është mjet themelor shprehës.

ZH

Zhanër – paraqitje e pikturave nga jeta e përditshme nëpërmjet veprës artistike.



Nxënës i dashur,

Kur do arrish deri tek këto teste, veçse je i njoftuar me pjesën më të madhe të përmbajtjeve të librit. Deri sot, me siguri ke mësuar gjëra të panjohura, ndërsa për disa ke pasë njohuri.

Këto teste janë vetëm një kontrollim për njohuritë tuaja. Disa pjesë nga testi janë me përgjigje rreth pyetjeve të parashtruara, ndërsa disa zgjidhen me vizatim.

Shpresojmë së testet nuk janë të rënda dhe se me pak mundim do t'i zgjidhni.

Testet do t'i plotësoni atëherë kur do të ju thotë arsimtari nga arsimi figurativ, të parin para gjysëmvjetorit të parë.

Përgjigjet e çdo pyetjeje vlerësohen me pika, të cilat do të caktohen nga arsimtari.

Testet janë të krijuara ashtu që ato mund të shkëputen dhe t'i jepen arsimtarit për vlerësim.

Të urojmë zgjidhje të suksesshme të testeve, nota të mira dhe kënaqësi gjatë punës!

EMRI DHE MBIEMRI _____
KLASA _____
SHKOLLA _____
DATA _____

1. Cila nga këto dy skulptura të pëlqen më shumë?



2. Shkruaji elementet e artit figurative:

3. Rrethoju cilat ngjyra janë sekondare.

- | | |
|-----------------------------------|--|
| <input type="checkbox"/> e kuqja | <input type="checkbox"/> e kaltra |
| <input type="checkbox"/> vjollcë | <input type="checkbox"/> e gjelbra |
| <input type="checkbox"/> e verdhë | <input type="checkbox"/> e portokallta |

4. Si është kjo baraspeshë?



5. Cila nga këto format është tredimensionale?



6. Si është kjo formë?



7. Emërto llojin e ngjyrave?






TEST 1

106

8. Si është ky kontrast?



10. Me çfarë është arritur unitet në këtë vepër?



12. Si quhet kjo mënyrë e të paraqiturit hapësirës?



14. Cila kahje dominon në këtë vepër?



9. Trego se cilat vija janë harmonike dhe cilat janë kontraste?




11. Me çfarë është arritur harmoni në këtë vepër?



13. Me çfarë është arritur iluzion i të hapësirës?



15. Si është ky ritëm?



EMRI DHE MBIEMRI _____
KLASA _____
SHKOLLA _____
DATA _____

1. A shikoni emisione dedikuar artit /artistëve?

po

jo

2. Trego dy artistë që të pëlqejnë?

3. Përmend vepra nga arti figurativ që të pëlqejnë?

- _____

- _____

- _____

4. Përmendi disa reklama që të kanë lënë më shumë përshtypje?

- _____

- _____

- _____

5. Përmend tre shembuj të dizajnit grafik?

- _____

- _____

- _____

6. Trego dy artistë nga Maqedonia.

- _____

- _____

- _____

7. Në cilën fushë të artit figurative bën pjesë kjo vepër?



8. Në cilën fushë të artit figurative bën pjesë kjo vepër?



TEST 2

108

9. Në cilën fushë të artit figurative bën pjesë kjo vepër?



11. A mund të gjejsh autorin e kësaj vepre?



13. Në cilën fushë të artit figurative bën pjesë kjo vepër?



15. Në cilën fushë të artit figurative bën pjesë kjo vepër?



10. Si quhet kjo vepër?



12. Cili motiv është paraqitur në këtë vepër?



14. A e dini se kur është bërë ky vizatim?



16. A mund të gjejsh se nga cili vend është kjo vepër?



